








# REGJISTRIMI I POPULLSISË, EKONOMIVE FAMILJARE DHE BANESAVE NË KOSOVË

# 2024

## TË DHËNAT E PARA FINALE










# REGJISTRIMI I POPULLSISË, EKONOMIVE FAMILJARE DHE BANESAVE NË KOSOVË

# 2024

## TË DHËNAT E PARA FINALE



Botues: Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK)  
Data e botimit: Dhjetor/2024  
© Agjencioni i Statistikës së Kosovës  
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.  
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,  
ku mund të qasenë përmes ueb-faqes së ASK-së:  
<http://ask.rks-gov.net>

# PËRMBAJTJA

Faqe

<b>Hyrje</b> .....	<b>5</b>
<b>REZULTATET PËRFUNDIMTARE</b> .....	<b>5</b>
<b>FJALOR I TERMAVE</b> .....	<b>6</b>
<b>KAPITULLI 1</b> .....	<b>17</b>
<b>INFORMACION I PËRGJITHSHËM</b> .....	<b>17</b>
<b>RRETH REGJISTRIMIT TË POPULLSISË</b> .....	<b>17</b>
Objektivat e Regjistrimit .....	<b>18</b>
<b>KAPITULLI 2</b> .....	<b>32</b>
<b>TABELAT PËRMBLEDHËSE</b> .....	<b>32</b>
Tab. 2.1 – Popullsia rezidente dhe ekonomitë familjare.....	<b>32</b>
Tab. 2.2 – Arsimimi.....	<b>33</b>
Tab. 2.3 – Ndërtesat dhe Banesat.....	<b>34</b>
Tab. 2.4 – Popullsia sipas gjinisë dhe vitit të regjistrimit .....	<b>34</b>
Tab. 2.5 – Popullsia sipas grupmoshës dhe vitit të regjistrimit.....	<b>35</b>
Tab. 2.6 – Treguesit e strukturës së moshës sipas vitit të regjistrimit.....	<b>35</b>
<b>KAPITULLI 3</b> .....	<b>36</b>
<b>POPULLSIA, EKONOMITË FAMILJARE DHE NJËSITË E BANIMIT</b> .....	<b>36</b>
Tab. 3.1 – Popullsia rezidente në Kosovë sipas gjinisë dhe moshës së vetme.....	<b>36</b>
Tab. 3.2 – Popullsia sipas grupmoshave, gjinisë dhe tipit të vendbanimit (urbane/rurale) .....	<b>39</b>
Tab. 3.3 – Popullsia rezidente e moshës 15 vjeç e mbi sipas gjinisë, tipit të vendbanimit (urbane/rurale) dhe statusit martesor .....	<b>41</b>
Tab. 3.4 – Popullsia rezidente e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit martesor, gjinisë dhe grupmoshës .....	<b>42</b>
Tab. 3.5 – Popullsia rezidente sipas përkatësisë etnike, gjinisë dhe grupmoshës .....	<b>44</b>
Tab. 3.6 – Popullsia rezidente sipas religjionit, gjinisë dhe grupmoshës .....	<b>46</b>
Tab. 3.7 – Popullsia rezidente sipas gjuhës amtare, gjinisë dhe moshës.....	<b>48</b>
Tab. 3.8 – Ekonomitë Familjare private në banesa të zakonshme sipas tipit të vendbanimit (urbane/rurale), posedimit të paisjeve .....	<b>50</b>
Tab. 3.9 – Popullsia rezidente me vështirësi afatgjate, sipas moshës, shkallës së vështirësisë në kryerjen e aktiviteteve ditore .....	<b>51</b>

Tab. 3.9a - Përqindja e popullsinë me vështirësi ( pak, shumë dhe nuk mundet fare) në raport me popullsinë totale.....	52
Tab. 3.10 – Njësitë e banimit të shfrytëzuara sipas statusit të banimit dhe tipit të njësisë së banimit .....	52
Tab. 3.11 – Njësitë e banimit të shfrytëzuara sipas pronësisë së banimit dhe tipit të njësisë së banimit.....	52
Tab. 3.12 - Dëmet nga lufta 1998/1999 në Ekonomitë Familjare në nivel vendi .....	53
<b>KAPITULLI 4.....</b>	<b>54</b>
<b>POPULLSIA, EKONOMITË FAMILJARE NË KOMUNAT E KOSOVËS .....</b>	<b>54</b>
Tab. 4.1 – Popullsia rezidente sipas gjinisë dhe grupmoshave në komunat e Kosovës .....	54
Tab. 4.2 - Popullsia sipas statusit martesor, gjinisë dhe komunës .....	60
Tab. 4.3 – Popullsia sipas vendbanimit të parë rezident dhe vendbanimit aktual sipas gjinisë dhe komunës.....	63
Tab. 4.4 - Popullsia sipas përkatësisë etnike, gjinisë dhe komunës.....	66
Tab. 4.5 - Popullsia sipas religjionit, gjinisë dhe komunës.....	69
Tab. 4.6 - Popullsia sipas gjuhës amtare, gjinisë dhe komunës .....	72
Tab. 4.7 - Popullsia 5 deri 29 vjeç që aktualisht vijon shkollimin sipas nivelit, gjinisë dhe komunës ..	75
Tab. 4.8 – Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimimit më të lartë të përfunduar, gjinisë dhe komunës.....	78
Tab. 4.9 – Ekonomitë Familjare sipas numrit të anëtarëve dhe komunës.....	81
Tab. 4.10 – Numri i ndërtesave me së paku një banesë të shfrytëzuar të zakonshme, numri mesatar i banesave për ndërtesë, numri i banesave të zakonshme, numri i banesave të zbrazëta, sipas komunës .....	82
Tab. 4.11 – Banesat sipas statusit të banimit dhe komunës.....	83
Tab. 4.12 – Ekonomitë Familjare private sipas statusit të banimit të ekonomisë familjare dhe komunës .....	84
Tab. 4.13 – Ndërtesat e banuara të zakonshme sipas periudhës së ndërtimit të ndërtesës dhe komunës .....	85
<b>KAPITULLI 5.....</b>	<b>86</b>
<b>POPULLSIA, SIPAS REGJISTRIMIT TË POPULLSISË DHE VLERËSIMI NË KATËR KOMUNAT VERIORE .....</b>	<b>86</b>
Tab. 5.1 - Popullsia sipas përkatësisë etnike, gjinisë dhe komunës sipas regjistrimit të popullsisë dhe vlerësimi në katër komunat veriore .....	87
Tab. 5.2 - Popullsia sipas religjionit, gjinisë dhe komunës sipas regjistrimit të popullsisë dhe vlerësimi në katër komunat veriore.....	90



Tab. 5.3 - Popullsia sipas gjuhës amtare, gjinisë dhe komunës sipas regjistrimit të popullsisë dhe vlerësimi në katër komunat veriore.....	93
<b>SHTOJCA 1.....</b>	<b>96</b>
<b>HARTAT TEMATIKE.....</b>	<b>96</b>
Fig. 1- Popullsia sipas grupmoshës në Kosovë .....	96
Fig. 2 - Popullsia sipas raportit gjinor në Kosovë .....	97
Fig. 3 - Popullsia urbane në Kosovë.....	98
Fig. 4 – Dendësia e popullsisë në Kosovë .....	99
Fig. 5 – Dendësia e popullsisë në Kosovë sipas grid-it.....	100

# Hyrje

## REZULTATET PËRFUNDIMTARE

### të dala nga regjistrimi i popullsisë 2024

Të nderuar qytetarë, bashkëpunëtorë dhe partnerë institucionalë,

Prezantimi i të dhënave të para finale nga Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2024, vetëm disa muaj pas përfundimit të tij, është një ngjarje e rëndësishme jo vetëm për institucionin tonë, por edhe për të gjithë përdoruesit e të dhënave, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Ky proces, i organizuar sipas standardeve më të avancuara teknologjike dhe metodologjike, shënon një hap të rëndësishëm drejt ofrimit të të dhënave të plota për fusha të ndryshme, të cilat do të ndihmojnë në planifikimin më të mirë socio-ekonomik dhe strategjik të vendit tonë.

Regjistrimi i popullsisë ishte një aktivitet jetik për të siguruar të dhëna të sakta mbi numrin dhe karakteristikat demografike, sociale dhe ekonomike të popullsisë sonë. Të dhënat do të ofrojnë një pamje të përditësuar mbi kushtet e jetesës dhe infrastrukturën banesore, duke krijuar një bazë të fuqishme për vendimmarrje të informuar dhe për politika publike të bazuara në evidenca.

Për herë të parë në historinë e regjistrimeve në Kosovë, ky proces u realizua plotësisht në format digjital, duke reduktuar gabimet, përmirësuar shpejtësinë e përpunimit dhe publikimit, si dhe duke garantuar cilësi më të lartë të të dhënave të mbledhura. Momenti i referencës për këtë regjistrim ishte mesnata e datës 4-5 prill 2024, duke mundësuar një "fotografi" të plotë të realitetit demografik dhe ekonomik të vendit tonë.

Respektimi i kriterëve dhe definicioneve standarde ndërkombëtare siguron përputhjen e të dhënave të Kosovës me praktikën më të mira globale, duke forcuar pozitën tonë në arenën ndërkombëtare.

Rezultatet e regjistrimit do të jenë një udhërrëfyes i çmuar për hartimin e politikave zhvillimore, alokimin e burimeve publike dhe avancimin e planeve strategjike në nivel lokal dhe kombëtar. Ato do të ndihmojnë gjithashtu në përmirësimin e statistikave dhe do të ofrojnë një bazë të freskët për hulumtime të tjera.

Falë punës së palodhshme të ekipit tonë, bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe pjesëmarrjes aktive të qytetarëve tanë, ne ia dolëm të realizojmë me sukses këtë projekt madhor. Ju falënderojmë për besimin dhe angazhimin tuaj në një proces që pasqyron realitetin e gjithë shoqërisë së Kosovës.

Duke shprehur mirënjohjen time për të gjithë ata që kontribuan në këtë proces, ju ftoj të përdorni të dhënat e regjistrimit si një burim të besueshëm dhe frytdhënës për të ndërtuar një Kosovë të drejtë dhe të zhvilluar.

Dhjetor, 2024

U.d. i Kryeshefit Ekzekutiv të ASK-së  
Avni Kastrati



# FJALOR I TERMAVE

## Përkufizimet kryesore të temave - variablat e përgjithshme

### **Regjistrimi**

Regjistrimi është procesi zyrtar i numërimit që kryhet nga një shtet në një kohë të caktuar për të gjithë popullsinë (personat), duke mbledhur të dhëna demografike, ekonomike, sociale, arsimore, bujqësore dhe informata të tjera për secilin individ. Regjistrimi në Kosovë është realizuar përmes intervistave ballë për ballë (*face-to-face*), ku të dhënat janë mbledhur për çdo ekonomi familjare/individ.

### **Popullsia rezidente**

Popullsia rezidente përfshin të gjithë individët që kanë vendbanimin e zakonshëm në territorin e një vendi dhe qëndrojnë ose kanë qëndruar për të paktën 12 muaj, ose që kanë qëllim të qëndrojnë për një periudhë të tillë.

### **Popullsia jo-rezidente**

Popullsia jo-rezidente përfshin individët që kanë vendbanim të zakonshëm jashtë Kosovës, por që ndodhen përkohësisht brenda territorit të saj për qëllime si puna, studimet, turizmi ose vizitat familjare. Sipas standardeve ndërkombëtare, këta persona nuk përfshihen në statistikat e popullsisë rezidente të Kosovës, por mund të regjistrohen për qëllime statistikore të veçanta, si vlerësimi i flukseve të migrimit, analizat ekonomike dhe studimet mbi shërbimet publike të ofruara për këtë kategori.

### **Ekonomia familjare**

Ekonomia familjare nënkupton individin, bashkësinë familjare ose një bashkësi tjetër personash (individësh), të cilët jetojnë së bashku dhe janë të vendosur plotësisht ose pjesërisht në një njësi banesore, si dhe furnizohen me gjëra ushqimore dhe gjëra të tjera esenciale për jetesë. Anëtarët e këtij grupi mund të bashkojnë të ardhurat e tyre në një masë më të madhe ose më të vogël.

### **Ekonomia familjare institucionale-kolektive**

Ekonomia institucionale përfshin personat të cilët kanë nevojë për strehë dhe ekzistencë, e cila u sigurohet nga një institucion. Institucioni nënkuptohet të jetë një organ ligjor për qëllime të banimit afatgjatë, që ofron shërbime për një grup personash. Këto institucione zakonisht kanë pajisje të përbashkëta që ndahen nga banorët (si banjat, dhomat e ndejës, dhomat e ngrënies, dhomat e fjetjes, etj.).

Ekonomitë familjare institucionale janë grupuar në kategoritë vijuese:

- Vendbanime/konvikte për studentë
- Spitale dhe sanatoriume
- Shtëpi përkujdesi
- Objekte për persona me aftësi të kufizuara
- Institucione psikiatrike
- Shtëpi për të moshuar
- Shtëpi për fëmijë dhe jetimore
- Kazerma ushtarake dhe policore
- Burgje dhe shtëpi korrektimi
- Manastire
- Shtëpi për punëtorë
- Kampe refugjatësh

- Të tjerë (përfshirë objektet e strehimit të asistuar dhe institucionet e mirëqenies).

Ekonomitë familjare institucionale zakonisht gjenden brenda kuarteve të banimit kolektiv.

### **Familja**

Familja përkufizohet si dy ose më shumë persona, të cilët jetojnë në të njëjtën ekonomi familjare dhe që janë të lidhur si burrë dhe grua (ose partnerë që bashkëjetojnë) me ose pa fëmijë, ose prind me një fëmijë. Prandaj, koncepti i familjes përfshin:

- Një çift pa fëmijë;
- Një çift me një ose më shumë fëmijë të pamartuar;
- Një prind i vetëm me një ose më shumë fëmijë të pamartuar.

### **Ndërtesë**

Ndërtesë është çdo strukturë e pavarur që përmban një ose më shumë banesa, dhoma ose hapësira të tjera, që është e mbuluar me kulm dhe e mbyllur me mure, ose e ndarë me mure të brendshme, të cilat shtrihen prej themeleve deri në kulm. Ndërtesat mund të jenë të destinuara për qëllime banimi, bujqësore, komerciale, industriale, kulturore ose për ofrimin e shërbimeve të tjera.

### **Urbane**

Zonë e urbanizuar gjeografike e definuar në nivel vendbanimi, e cila karakterizohet me densitet më të lartë të popullsisë krahasuar me zonat përreth. Në regjistrimin e popullsisë në Kosovë, një zonë përkufizohet si urbane përmes vendimit administrativ të komunës përkatëse.

### **Rurale**

Zonë gjeografike jo e urbanizuar, e përkufizuar në nivel vendbanimi, që karakterizohet me densitet më të ulët të popullsisë. Zakonisht, shumica e tokës në këto zona shfrytëzohet për bujqësi, krahasuar me zonat përreth. Në regjistrimin e popullsisë në Kosovë, një zonë përkufizohet si rurale përmes vendimit administrativ të komunës përkatëse.

### **Popullsia e moshës 1 vjeç e më lart**

Përfshin të gjithë individët që kishin mbushur moshën 1 vjeç në datën e regjistrimit (më shumë se 365 ditë).

### **Popullsia e moshës 15 vjeç e më lart**

Përfshin të gjithë individët që kishin mbushur moshën 15 vjeç në datën e regjistrimit.

## Karakteristikat kryesore të ndërtesave

### **Ndërtesë banimi**

Ndërtesë e dizajnuar ose dedikuar për banim.

### **Shtëpi e veçuar e ndarë në vete**

Shtëpi individuale që nuk është e ngjitur me asnjë objekt tjetër.

### **Shtëpi gjysmë e ndarë**

Dy banesa të cilat janë të bashkuara me një mur të përbashkët.

### **Rresht apo varg shtëpish**

Ndërtesë që përbëhet nga tre ose më shumë banesa në varg, ku secila prej tyre ka dalje të veçantë. Ndërtesë apo blloqe apartamentesh, janë bllok i banesave, të cilat kanë tre ose më shumë banesa, të cilat kanë dalje të përbashkët;

### **Ndërtesë që nuk është për banim**

Ndërtesë e cila, nga dukja e jashtme, nuk është destinuar për banim dhe përbëhet vetëm ose kryesisht nga njësi të përdorura për qëllime bujqësore, komerciale ose për ofrimin e shërbimeve si xhami, kishë, fabrikë, etj.

### **Numri i kateve të ndërtesës**

Numri i kateve numërohet duke filluar nga kati përdhes e lart, duke përfshirë edhe katin përdhes (i cili llogaritet si kati numër një).

### **Viti i ndërtimit të ndërtesës**

Viti i ndërtimit të ndërtesës konsiderohet viti i përfundimit të saj ose viti kur ndërtesa ka pësuar ndryshime të mëdha ndërtimore. Për një banesë të përfunduar që ndodhet në një ndërtesë të papërfunduar, shënohet viti i përfundimit të ndërtimit të banesës.

## Karakteristikat kryesore të banesave/njësive të banimit

### **Kuarti i banimit kolektiv (banesë kolektive)**

Kuart i banimit kolektiv është një ose më shumë ndërtesa të projektuara për t'u banuar nga një grup individësh ose nga disa ekonomi familjare dhe që përdoren si vendbanim i zakonshëm nga së paku një person në kohën e regjistrimit. Kuartet e banimit kolektiv përfshijnë:

- (a) Hotelet;
- (b) Institucionet;
- (c) Kampet.

### **Banesa e zakonshme**

Banesa e zakonshme përkufizohet si një dhomë ose tërësi dhomash me pjesët përcjellëse të tyre (p.sh., paradhoma, korridore, etj.) në një ndërtesë të përhershme ose strukturë të ndarë e cila është planifikuar (ose shndërruar) për banim të përhershëm. Banesa duhet të jetë: E rrethuar me mure dhe e mbuluar me kulm; të ketë qasje direkte nga një rrugë, shkallë

publike/komunale, shteg, galeri ose tokë (d.m.th., ku shfrytëzuesit mund të hyjnë dhe të dalin pa kaluar nëpër dhomat ose shtëpitë e ndonjë ekonomie tjetër familjare).

### **Njësitë e tjera banesore**

Njësitë e tjera banesore përfshijnë njësi që janë:

- Të lëvizshme (p.sh., tenda ose dhoma rimorkio);
- Gjysmë të përhershme (p.sh., kabina ose kasolle);
- Të improvizuara (p.sh., streha ose baraka);
- Nuk janë të destinuara për banim (p.sh., garazhe, shitore, strehime natyrore), por që në kohën e regjistrimit përdoren si banim i zakonshëm nga një ose më shumë persona.

### **Të pastrehët**

Persona që flenë rrugëve dhe nuk kanë banim të përhershëm, si dhe që zakonisht janë në lëvizje.

### **Banesa të banuara (statusi i shfrytëzimit të banesës/shtëpisë)**

Për secilën ekonomi familjare që jeton në një banesë, duhet të përcaktohet statusi i shfrytëzimit të njësisë banesore.

### **E shfrytëzuar nga banorë që nuk përfshihen në regjistrim**

Banesa është e banuar nga persona që nuk përfshihen në regjistrimin e popullsisë, si personeli diplomatik, personeli i huaj ushtarak dhe EULEX-i.

### **E shfrytëzuar për qëllime të përkohshme ose përdorim dytësor**

Banesa shfrytëzohet për qëllime të përkohshme ose si banesë dytësore (p.sh. punë sezonale, pushime etj.).

### **Banesë e dedikuar për qëllime biznesi**

Banesat që gjatë kohës së regjistrimit janë të shfrytëzuara për qëllime biznesore, si avokaturë, ordinancë mjekësore etj.

### **Banesë e pabanuar**

Banesat që gjatë kohës së regjistrimit janë të përshtatshme për banim, por janë të pabanuara, të lira ose të dedikuara për shitje, qira, prishje apo të blera nga persona që kanë vendbanim diku tjetër.

### **Banesë/shtëpi e ndarë, e shfrytëzuar nga e njëjta ekonomi familjare**

Banesat ose shtëpitë që janë të ndara, por të shfrytëzuara nga e njëjta ekonomi familjare.

### **Banesë/shtëpi e pabanuar (jashtë vendit)**

Banesat ose shtëpitë ku ekonomia familjare jeton jashtë vendit.

### **Numri i ekonomive familjare në njësinë banesore**

Numri i ekonomive familjare që jetojnë në një njësi banesore.

### **Numri i personave me vendbanim të zakonshëm në njësinë banesore**

Numri i personave që kanë vendbanim të zakonshëm në këtë njësi banesore.

## **Numri i dhomave në dispozicion duke përfshirë edhe dhomat për qëllime biznesi ose profesionale**

### **Dhoma**

Një dhomë është njësi hapësinore e banesës për banim, e ndarë nga dhomat e tjera me mure të qëndrueshme (nga dyshemeja në tavan ose kulm), me një lartësi minimale prej 2 m dhe madhësi të mjaftueshme për të zënë një shtrat për të rritur (së paku 4 metra katrorë). Në numrin e përgjithshëm të dhomave përfshihen:

- Dhomat e zakonshme të fjetjes dhe të ndejës;
- Bodrumet e banueshme dhe nënçatitë;
- Kuzhinat dhe hapësirat e tjera të ndara, që shfrytëzohen për banim.

### **Nuk përfshihen:**

- Kuzhinat më të vogla se 4 m<sup>2</sup> (aneksi i kuzhinës);
- Verandat, dhomat e pajisjeve (p.sh. dhomat e bojlerëve dhe të larjes së rrobave);
- Paradhomat dhe banjat apo tualetet (edhe nëse janë më të mëdha se 4 m<sup>2</sup>).

Dhomat e ndara nga banesa, por që janë në funksion të saj dhe shfrytëzohen nga ekonomia familjare, konsiderohen si pjesë e banesës.

### **Dhoma për qëllime biznesi ose profesionale**

Dhomat që janë pjesë e banesës, por përdoren kryesisht për qëllime biznesi, si dyqane, zyra apo punishte.

**Sistemi kryesor i furnizimit me ujë në njësinë e banesës** është dallimi ndërmjet banesave të cilat kanë ose që nuk kanë sistem të furnizimit me ujë përmes sistemit të ujësjellësit.

### **Sistemi i furnizimit me ujë nga një shërbim publik**

Furnizimi me ujë bëhet përmes gypave (uji nga rubineti) dhe shpërndahet nga ofruesi publik i shërbimit (shembull i kësaj është sistemi i ujësjellësit komunal).

### **Sistemi i furnizimit me ujë nga shërbimet tjera**

Furnizimi me ujë bëhet përmes gypave (uji nga rubineti) por nuk shpërndahet sipas skemës së shërbimit publik. Kjo ndodhë në rastet kur uji silltet në shtëpi përmes pompave prej ndonjë pusi/bunar (veçanërisht në zonat rurale, hidrofor) ose prej ndonjë ujëvare natyrore/ rënie e lirë (veçanërisht në zonat malore).

### **Sistemi i furnizimit me ujë brenda ndërtesës, por jashtë njësisë së banesës**

Kjo ndodhë në rastet kur furnizimi me ujë ekziston në ndërtesë, por jo edhe në njësinë banesore. Furnizimi me ujë mund të jetë i përbashkët për disa banesa brenda ndërtesës.

### **Sistemi i furnizimit me ujë jashtë ndërtesës**

Qasja në ujë ekziston vetëm jashtë ndërtesës.

### **Nuk ka sistem të furnizimit me ujë**

Nuk ka fare sistem të furnizimit me ujë (as në njësinë banesore e as jashtë ndërtesës).

### **Shkarkimi i ujërave të zeza nëpërmjet kanalizimit të lidhur me sistemin publik**

Ekonomitë familjare të cilat në banesë kanë shkarkim të ujërave të zeza përmes kanalizimit të lidhur me sistem publik.

### **Shkarkimi i ujërave të zeza nëpërmjet kanalizimit të lidhur me sistemin privat**

Ekonomitë familjare të cilat në banesë kanë shkarkim të ujërave të zeza përmes kanalizimit të lidhur me sistem privat.

### **Të gjitha mënyrat e tjera (p.sh. kanal, gropë septike, lumë etj.)**

Rastet kur shkarkimi i ujërave të zeza nuk bëhet nëpërmjet sistemit të kanalizimit, por në kanale, gropa septike, lumenj etj.

**Nuk ka sistem kanalizimi.** Njësia banesore nuk ka fare sistem për shkarkimin e ujërave të zeza.

### **Tualet me shpëlarje brenda njësisë së banesës**

Njësia banesore posedon tualet me shpëlarje brenda njësisë së banesës.

### **Tualet me shpëlarje jashtë njësisë së banimit por brenda ndërtesës**

Ka tualet me shpëlarje brenda ndërtesës por jashtë njësisë së banimit.

### **Tualet me shpëlarje jashtë ndërtesës**

Qasja në tualet me shpëlarje ka vetëm jashtë ndërtesës.

### **Nuk ka tualet me shpëlarje**

Nuk ka tualet me shpëlarje (veçanërisht në zonat rurale) dhe mund të përdoren një lloj tjetër tualetesh (të ashtuquajturat 'nevojtores').

### **Me dush apo vaskë të fiksuar**

Banesat që kanë të paktën një dush ose vaskë të fiksuar.

### **Pa dush apo vaskë të fiksuar**

Banesat ku mungon dushi ose vaska e fiksuar.

### **Kuzhina**

Definohet si një dhomë (ose pjesë e një dhome) me së paku 4 m<sup>2</sup>, e projektuar dhe pajisur për përgatitjen e ushqimeve kryesore, pavarësisht nëse përdoret edhe për ngrënie, fjetje ose banim.

### **Aneks kuzhine**

Kuzhinë më e vogël se 4 m<sup>2</sup>.

### **Pajisjet e gatimit të vendosura në dhomë tjetër**

Pajisjet për përgatitjen e ushqimit ndodhen në një dhomë tjetër brenda njësisë banesore.

### **Pa kuzhinë, aneks kuzhine ose pajisje për gatim**

Në banesë nuk ka as kuzhinë, as aneks kuzhine dhe as pajisje të tjera për gatim.

### **Ngrohja qendrore nga sistemi i ngrohjes publike.**

Ngrohja qendrore sigurohet përmes një sistemi publik (ngrohtore).

### **Ngrohja qendrore nga sistemi i instaluar brenda ndërtesës ose njësisë banesore.**

Ngrohja qendrore sigurohet përmes pajisjeve të instaluara privatisht në ndërtesë ose në vetë njësinë banesore.

### **Stufa**

Aparat i lëvizshëm ose i fiksuar që përdoret për ngrohje ose gatim.



## **Oxhaku/Kamini**

Strukturë e hapur në dhomë, zakonisht në mur, e përdorur për ndezjen e zjarrit.

**Ngrohëse elektrike e lëvizshme.** Aparat elektrik i lëvizshëm që përdoret për ngrohje.

**Të tjera.** Për shembull, sistemi i ngrohjes solare.

## **Pa ngrohje**

Banesat që nuk kanë asnjë lloj sistemi ngrohjeje.

## **Lloji kryesor i energjisë që përdoret për ngrohje**

I referohet llojit të energjisë që përdoret më shpesh nga ekonomia familjare për ngrohjen e njësisë banesore. Nëse përdoren disa lloje të energjisë, shënohet ai që përdoret më shumë.

## **Struktura/Përbërja e Ekonomive Familjare**

### **Anëtar i ekonomisë familjare**

Çdo person që ka banim të zakonshëm në një ekonomi familjare.

### **Ekonomia familjare me një anëtar**

Ekonomi familjare që përbëhet nga një person i vetëm, i cili:

- jeton i vetëm në një njësi banesore, ose
- banon si qiraxhi në një dhomë të ndarë të njësisë banesore, por nuk bashkohet me asnjë banues tjetër për të formuar një ekonomi familjare me më shumë persona.

### **Ekonomia familjare shumë anëtarëshe**

Grup prej dy ose më shumë personash, të cilët mund të jenë ose jo të afërt me njëri-tjetrin dhe që jetojnë së bashku për të shfrytëzuar plotësisht ose pjesërisht një njësi banesore. Ata sigurojnë së bashku ushqim dhe gjëra të tjera të nevojshme për jetesë, ndërsa mund të bashkojnë të ardhurat në shkallë më të madhe apo më të vogël.

### **Ekonomia familjare pa asnjë familje**

Ekonomi familjare ku:

- jeton një person i vetëm, ose
- banesa ndahet vetëm me persona të paafërt sipas përkufizimit të regjistrimit (p.sh., bashkëbanuesit, partnerët e pamartuar, vëllezërit etj.).

### **Ekonomia familjare me një familje**

Ekonomi familjare e përbërë vetëm nga një familje.

## **Familjet sipas përbërjes**

### **Familje me burrë-grua, partnerë me kurorë**

Familje që përfshin të paktën një çift të ligjshëm burrë-grua, me ose pa fëmijë.

### **Familje me burrë-grua, partnerë pa kurorë**

Familje që përfshin të paktën një çift joformal burrë-grua (bashkim i palegalizuar), me ose pa fëmijë.

### **Familje me baba të vetëm**

Familje e përbërë nga një prind mashkull, pa partner, me të paktën një fëmijë të pamartuar.

### **Familje me nënë të vetme**

Familje e përbërë nga një prind femër, pa partner, me të paktën një fëmijë të pamartuar.

### **Familjet sipas fëmijëve**

#### **Familjet pa fëmijë që banojnë me ta**

Çifti burrë-grua (me ose pa bashkim të legalizuar) që jetojnë pa asnjë fëmijë të tyre.

#### **Familjet me të paktën një fëmijë nën 25 vjeç**

Çifti burrë-grua (me ose pa bashkim të legalizuar) që jetojnë me të paktën një fëmijë të tyre nën moshën 25 vjeç.

#### **Me fëmijën më të vogël të moshës 25 vjeç e më lart**

Çifti burrë-grua (me ose pa bashkim të legalizuar) që jetojnë me të paktën një fëmijë të tyre, ku më i riu prej tyre është 25 vjeç ose më i madh.

### **Kryefamiljari**

Kryefamiljari është personi referues në një ekonomi familjare. Lidhjet e të gjithë anëtarëve të tjerë të ekonomisë familjare përcaktohen në raport me këtë person. Për shembull, nëse kryefamiljari është «Z. Bardhi», partnerja e tij që jeton me të do të deklarohet si «gruaja e z. Bardhit», vëllai i tij si «vëllai i z. Bardhit», ndërsa gruaja e vëllait të tij si «kunata e z. Bardhit».

### **Statusi familjar**

Pozita e një personi në familje përcaktohet sipas lidhjes së tij/saj me partnerin ose sipas raportit hierarkik:

- Burrë/grua me kurorë
- Burrë/grua pa kurorë (bashkëjetesë)
- Prind i vetëm pa partner në familje
- Prind i vetëm me partner që jeton jashtë Kosovës
- Fëmijë i të dy prindërve
- Fëmijë i partnerit mashkull
- Fëmijë i partnerit femër
- Fëmijë me një prind të vetëm
- Person që nuk i takon asnjërës familje.

### **Mosha**

Mosha llogaritet në vite të plota. Për shembull, personat e moshës 25 vjeç janë ata që, deri në datën e regjistrimit, kanë festuar ditëlindjen e tyre të 25-të. Fëmijët e porsalindur që nuk kanë festuar ende ditëlindjen e parë konsiderohen të moshës 0 vjeç.

### **Raporti me kryefamiljarin**

#### **Burrë-grua me kurorë**

Burri ose gruaja e kryefamiljarit me bashkim të legalizuar.

#### **Burrë-grua pa kurorë**

Burri ose gruaja e kryefamiljarit me bashkim të palegalizuar (de facto, bashkimi njihet në aspektin shoqëror si martesë).

**Partner/e**

Partneri/partnerja e kryefamiljarit që jeton së bashku me të.

**Djalë/vajzë**

Djali apo vajza e kryefamiljarit.

**Dhëndër/reja**

Dhëndri apo reja (nusja e djalit) e kryefamiljarit.

**Baba/nëna**

Babai ose nëna e kryefamiljarit.

**Vjehërr/vjehrrë**

Vjehri ose vjehra e kryefamiljarit.

**Vëllai/Motra**

Vëllai ose motra e kryefamiljarit.

**Nipi/Mbesa**

Nipi ose mbesa e kryefamiljarit.

**Të afërmit e tjerë**

Të afërmit e tjerë të kryefamiljarit, p.sh., gjyshi/gjyshja, xhaxhai/halla, dhëndri/kunata, daja/tezja, balldyzka, etj.

**Lidhje tjetër**

Lidhje tjetër me kryefamiljarin, p.sh., ortak/ortake, njerku/njerka, thjeshtër/thjeshtër, etj.

**Jo të afërm**

**Anëtari** i ekonomisë familjare që nuk është i afërm i kryefamiljarit, p.sh., miku, nikoqiri, shërbëtori, mjeku i familjes, personi nën përkujdesje, etj.

## Karakteristikat kryesore të ekonomive familjare

**Statusi i shfrytëzimit të banesës**

Aranzhimi sipas të cilit ekonomia familjare e shfrytëzon njësinë e banimit.

**Formë tjetër e shfrytëzimit**

Ekonomia familjare e shfrytëzon tërë apo një pjesë të njësisë së banimit sipas ndonjë forme të veçantë të shfrytëzimit, p.sh., kur njësi banesore i është dhënë ekonomisë familjare pa pagesë nga punëdhënësi ose nga ndonjë i afërm.

## **Toka në pronësi apo në shfrytëzim**

Të gjitha sipërfaqet e tokës që janë në pronësi ose në shfrytëzim nga ekonomia familjare. Toka e regjistruar nuk duhet domosdoshmërisht të jetë në të njëjtën komunë ku jeton ekonomia familjare; ajo mund të jetë edhe në ndonjë komunë tjetër të Kosovës.

## **Karakteristikat kryesore të personave**

### **Gjinia biologjike**

Term që përdoret për të përshkruar karakteristikat fiziologjike dhe gjenetike që përcaktojnë nëse një individ është mashkull ose femër nga pikëpamja biologjike.

### **Përkatësia etnike**

Bazohet në kuptimin e përbashkët të historisë dhe origjinës territoriale (regjionale, kombëtare) të një grupi etnik apo komuniteti. Përkatësia etnike përfshin edhe karakteristika kulturore si: gjuha, besimi fetar, traditat specifike dhe/ose mënyra e jetës.

### **Besimi fetar**

Përmbledhje e sistemeve kulturore, sistemeve të besimit dhe pikëpamjeve botërore që lidhin njerëzimin me vlerat shpirtërore dhe ndonjëherë edhe ato morale.

### **Gjuha amtare**

Gjuha e parë që personi ka folur në fëmijërinë e hershme dhe të cilën ende e flet. P.sh., gjuha që personi e konsideron si gjuhën amtare, pavarësisht nëse e përdor ende apo jo.

### **Vendi i shtetësisë**

Shteti me të cilin personi ka një lidhje të veçantë ligjore, e cila është fituar sipas lindjes ose natyralizimit, qoftë përmes deklarimit, zgjedhjes, martesës ose ndonjë mënyre tjetër të përcaktuar nga legjislacioni shtetëror.

## Lista e simboleve

<b>%</b>	-	Përqindja
<b>‰</b>	-	Për mijë (promil)
<b>1-4</b>	-	Klasa e thjeshtë e numrave të plotë; p.sh.: nga 1 deri në 5, duke përjashtuar 5-in.
<b>0-4</b>	-	Grup intervali;
<b>90+</b>	-	Nëntëdhjetë vjeç e më lart;
<b>&lt;18</b>	-	Më e vogël (me pak) se tetëmbëdhjetë vjeç;
<b>:</b>	-	Të dhënat nuk janë në dispozicion; p.sh.: Kur të dhënat për një vendbanim të caktuar janë shumë të vogla për t'u publikuar pa cenuar konfidencialitetin, ose mungojnë (mungojnë të dhënat);
<b>0</b>	-	E dhëna është më e vogël se 0,5 e njësisë së dhënë të matjes.
<b>≈</b>	-	Përafërsisht

# KAPITULLI 1

## INFORMACION I PËRGJITHSHËM

### Rreth Regjistrimit të Popullsisë

Regjistrimi i Popullsisë (tutje: “Regjistrimi”) është një proces statistikor gjithëpërfshirës që përfshin mbledhjen, analizën dhe publikimin e të dhënave brenda një territori të caktuar. Ky proces, zakonisht i kryer çdo dhjetë vjet, është një moment i rëndësishëm për çdo shtet, pasi ofron një pasqyrë të saktë të gjendjes demografike, ekonomike dhe sociale të popullsisë.

Regjistrimi mbledh të dhëna statistikore të detajuara për:

- **Numrin e popullsisë:** Për të vlerësuar madhësinë dhe shpërndarjen e popullsisë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.
- **Karakteristikat demografike:** Përfshin të dhëna mbi moshën, gjininë, statusin martesor dhe përbërjen familjare.
- **Karakteristikat ekonomike dhe sociale:** Përfshin informacione mbi arsimin, punësimin dhe nivelin ekonomik të individëve dhe familjeve.
- **Gjendjen e ekonomive familjare dhe banesave:** Përmban të dhëna mbi kushtet e jetesës, tipologjinë e banesave dhe infrastrukturën e disponueshme.

Këto të dhëna janë të pazëvendësueshme, pasi ato krijojnë një bazë solide për studime të mëtejshme mbi dinamikën e popullsisë, si dhe për politikëbërjen në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Regjistrimi përfaqëson një nga metodat më të vjetra dhe më të ndërlikuara të grumbullimit të të dhënave statistikore. Ai përfshin çdo individ dhe njësi familjare brenda territorit të një shteti, që e bën regjistrimin unik në krahasim me metodat e tjera statistikore, pasi siguron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të popullsisë dhe krijon një pikë referimi për vlerësime dhe parashikime të mëvonshme demografike.

Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë (tutje: “ReKos” për vitin 2024), i realizuar në periudhën 5 prill - 24 maj 2024, përfaqëson një pikë kyçe në zhvillimin statistik të vendit. Ky është regjistrimi i dytë pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe regjistrimi i parë që është zbatuar plotësisht në format digjital, duke kontribuar në mbledhjen dhe analizën e të dhënave me standarde të avancuara teknologjike.

Momenti kritik në Regjistrim është një koncept thelbësor që përcakton kohën specifike që shërben si pikë referimi për mbledhjen e të dhënave të popullsisë dhe banesave, duke përfaqësuar një çast të caktuar në kohë, kur të gjitha të dhënat e regjistrimit konsiderohen të jenë të vlefshme dhe të mbledhura në përputhje me gjendjen faktike. Zgjedhja e këtij momenti është e rëndësishme për të siguruar që informacioni i mbledhur të jetë i saktë, i qëndrueshëm dhe i krahasueshëm. Ky moment është kryesor sepse eliminon paqartësitë që mund të lindin nga ndryshimet demografike të vazhdueshme, si lindjet, vdekjet, migrimet dhe lëvizjet e



brendshme. ReKos 2024 përfaqëson fotografinë demografike dhe socio-ekonomike të popullsisë banuese në Kosovë. Momenti i referencës apo momenti kritik i kësaj fotografie u përcaktua mesnata ndërmjet datës 04-05 prillit 2024.

## Objektivat e Regjistrimit

Regjistrimi është një proces thelbësor në administrimin e një shteti dhe përmbushjen e nevojave socio-ekonomike të shoqërisë. Ky proces përbën një burim të pasur të të dhënave demografike, ekonomike dhe shoqërore që ndihmojnë në krijimin e politikave publike të bazuara në evidenca dhe janë esenciale për shpërndarjen e drejtë të burimeve dhe për planifikimin e qëndrueshëm të zhvillimit në nivel lokal dhe qendror.

Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2024 në Kosovë përfaqëson një ndër ndërmarrjet më të rëndësishme statistike të vendit, duke u përqendruar në sigurimin e të dhënave të sakta dhe të përditësuara mbi aspektet demografike, sociale dhe ekonomike të popullsisë, si dhe mbi kushtet e banimit.

Në kuadër të Regjistrimit të Popullsisë në Kosovë 2024 (ReKos 2024), sigurimi i të dhënave të sakta dhe të përditësuara ishte një nga prioritetet kryesore. Ky komponent ishte jetik për të garantuar që vendimet politike, investimet publike dhe programet zhvillimore të bazohen në informacion të besueshëm dhe të saktë.

Regjistrimi përbën një burim shumë të rëndësishëm të të dhënave statistikore, të cilat do të shërbejnë për hartimin e politikave të bazuara në dëshmi, duke ndihmuar në shpërndarjen më të drejtë të burimeve publike në përputhje me nevojat e ndryshme të popullsisë, duke siguruar një ndarje më efikase dhe të barabartë midis nivelit lokal dhe qendror.

Një tjetër objektiv i rëndësishëm i Regjistrimit të vitit 2024 ishte vlerësimi i situatës demografike që nga regjistrimi i fundit i vitit 2011. Ky komponent është thelbësor për të vëzhguar ndryshimet në përbërjen dhe shpërndarjen e popullsisë, duke përfshirë tendencat e migrimit, ndryshimet në strukturën familjare dhe dinamikën e moshës. Njohja e këtyre ndryshimeve është jetike për të përballuar sfidat e reja sociale dhe ekonomike që vijnë me kalimin e kohës.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm ishte edhe harmonizimi i statistikave të Kosovës me standardet ndërkombëtare. Kjo përfshinte aplikimin e metodologjive të avancuara statistikore dhe ndjekjen e praktikave më të mira në përputhje me rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare, si Kombet e Bashkuara dhe Eurostati. Përafrimi me këto standarde siguron krahasueshmërinë ndërkombëtare të të dhënave dhe ndihmon në forcimin e kapacitetit të Kosovës për të qenë një partner i besueshëm në arenën ndërkombëtare.

Regjistrimi i vitit 2024 gjithashtu synonte të rriste kapacitetet e Kosovës për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave statistikore në format digjital. Duke avancuar në drejtim të digjitalizimit të proceseve statistikore, synohet përmirësimi i efikasitetit dhe saktësisë në mbledhjen e të dhënave, si dhe ulja e kostove administrative. Kjo përbën një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të sistemit statistikor të vendit dhe përputhshmërisë me trendet globale të përdorimit të teknologjive të reja në fushën e statistikave.

Nga kjo që u tha, Regjistrimi për vitin 2024 përfaqëson një aktivitet strategjik të rëndësishëm për zhvillimin e Kosovës. Të dhënat e mbledhura do të luajnë një rol kyç në procesin e

politikëbërjes së bazuar në dëshmi, duke ndihmuar në shpërndarjen e drejtë të burimeve dhe planifikimin e qëndrueshëm të zhvillimit në të gjitha nivelet e qeverisjes. Në një mjedis gjithnjë e më të ndërlikuar global dhe lokal, Regjistrimi i vitit 2024 shënon një hap të domosdoshëm për përmirësimin e menaxhimit të vendit dhe mirëqenien e qytetarëve të tij.

## **Legjislacioni**

Ligji për Regjistrimin e Popullsisë dhe Banesave përcaktoi qëllimet, përgjegjësitë, metodologjinë, përkufizimet dhe institucionet e përfshira.

Korniza legjislative e ReKos 2024 u hartua duke pasur parasysh standardet e përcaktuara nga Kombet e Bashkuara dhe praktikat më të mira evropiane, duke u përafëruar me rekomandimet e Eurostat-it, Komisionit Ekonomik për Evropën të OKB-së (UNECE) dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA). Përafrimi me këto standarde ka garantuar që regjistrimi të jetë i krahasueshëm me regjistrimet e tjera në rajon dhe më gjerë, duke siguruar cilësi dhe koherencë në të dhënat e mbledhura.

Ligji i Regjistrimit ka vendosur objektiva të qarta që synojnë mbledhjen e të dhënave të sakta dhe të detajuara për popullsinë dhe kushtet e banimit. Objektivat ligjore kanë garantuar fokusin në përmbushjen e nevojave të vendit për të dhëna statistikore, të cilat do të shërbejnë për planifikim strategjik, alokim të burimeve dhe formulim të politikave publike.

Korniza ligjore ka përcaktuar qartë rolin dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) si organin kryesor për realizimin e regjistrimit. Po ashtu, ligji ka krijuar një bazë për bashkëpunimin ndërinstitucional mes ASK-së dhe institucioneve të tjera shtetërore, përfshirë komunat, Ministrinë dhe organet e tjera. Ky koordinim ka qenë kyç për menaxhimin efikas të procesit.

Korniza legjislative ka shërbyer si një udhërrëfyes për buxhetin, duke siguruar një ndarje të qartë të përgjegjësisë financiare.

Një aspekt thelbësor i kornizës ligjore ka qenë mbrojtja e të dhënave personale të qytetarëve, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe standardet ndërkombëtare si Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave. Ky komponent ka garantuar që të dhënat e mbledhura gjatë regjistrimit të jenë të sigurta dhe të përdoren vetëm për qëllime statistikore.

Një element tjetër i rëndësishëm ka qenë edhe përfshirja e një mekanizmi për komunikim të hapur dhe të vazhdueshëm me qytetarët. Korniza ligjore ka krijuar bazën për vëzhgimin e procesit të Regjistrimit nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, duke siguruar një vlerësim të pavarur për cilësinë dhe korrektësinë e regjistrimit. Një gjë e tillë e ka rritur ndjeshëm besueshmërinë e rezultateve përfundimtare.

## **Financimi i Projektit të Regjistrimit**

Për realizimin e projektit të Regjistrimit janë shpenzuar rreth 10.7 milionë euro, të cilat u mbuluan kryesisht nga buxheti i Kosovës (98.5%). Mbështetja e donatorëve ndërkombëtarë, përfshirë Eurostat, UNFPA dhe Bankën Botërore, ishte gjithashtu e rëndësishme për aktivitete specifike si metodologjia, trajnimi dhe fushatat sensibilizuese. Me një buxhet të parashikuar prej 14.9 milionë eurosh, ky projekt kërkoi një qasje të mirë strukturuar dhe efektive në menaxhimin financiar për të siguruar përdorimin optimal të fondeve.

## **Historik i shkurtër i regjistrimeve të Popullsisë në Kosovë**

Regjistrimet e popullsisë janë një praktikë thelbësore për të siguruar të dhëna të sakta demografike dhe ekonomike, të cilat janë të domosdoshme për planifikimin dhe zhvillimin socio-ekonomik të një vendi. Sipas standardeve ndërkombëtare, regjistrimet duhet të kryhen çdo dhjetë vjet, pasi ndryshimet demografike dhe ekonomike që ndodhin brenda kësaj periudhe janë domethënëse për hartimin e politikave të qëndrueshme.

### **Regjistrimet e para (1948-1981)**

Në Kosovë, regjistrimi i parë i popullsisë u zhvillua në vitin 1948 dhe më pas në vitin 1953. Nga ajo kohë, regjistrimet u organizuan çdo dekadë: në vitet 1961, 1971 dhe 1981. Këto regjistrime u kryen në kuadër të ish-Jugosllavisë dhe ofruan të dhëna për rritjen e popullsisë, ndryshimet strukturore dhe lëvizjet migratore, duke përfaqësuar burime të rëndësishme të statistikave për zhvillimin rajonal.

### **Ndërprerja dhe mosrealizimi i regjistrimit (1991)**

Në vitin 1991, regjistrimi i popullsisë në Kosovë nuk u realizua për shkak të ndërhyrjeve sistematike dhe masave represive të aplikuara nga regjimi serb ndaj popullsisë shqiptare. Pas shpërbërjes së autonomisë së Kosovës në vitin 1989, Serbia zbatoi një seri masash të dhunshme që synonin marginalizimin e shqiptarëve nga institucionet publike, duke përfshirë largimin masiv të tyre nga vendet e punës në administratë dhe nga personeli i Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Në këtë atmosferë represive, shqiptarët refuzuan të merrnin pjesë në regjistrim, duke e parë atë si një mjet për legjitimimin e regjimit serb në Kosovë.

Në vend të një regjistrimi të zakonshëm, Enti Federativ Jugosllav, me seli në Serbi, përpiloi vlerësime të njëanshme për popullsinë e Kosovës. Këto të dhëna nuk u pranuan as nga institucionet kosovare dhe as nga ato ndërkombëtare, duke u konsideruar si jo të sakta, të besueshme dhe të motivuara politikisht.

### **Sfidat e pasluftës dhe rekomandimet ndërkombëtare (2001-2011)**

Pas luftës së viteve 1998-1999, Kosova kaloi në një periudhë të vështirë rindërtimi, duke e pasur të pamundur organizimin e një regjistrimi të mirëfilltë deri në vitin 2011 për shkak të zhvendosjeve të mëdha të popullsisë dhe pasigurisë politike. Ndërkohë, gjatë administratës nga Kombet e Bashkuara (1999-2008), regjistrimi u planifikua disa herë, por u shty deri në vitin 2011 me rekomandimin e Eurostat-it për të siguruar përputhshmëri me standardet ndërkombëtare dhe krahasueshmëri me vendet e tjera të rajonit.

### **Regjistrimi i Vitit 2011**

Pas dy dekadash pa regjistrim zyrtar, Kosova realizoi regjistrimin e saj të parë të mirëfilltë të popullsisë më 1 prill 2011. Ky regjistrim shënoi një pikë kthese për shtetin e ri të Kosovës, duke qenë regjistrimi i parë që u organizua në mënyrë të pavarur pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008. Procesi u krye nën mbikëqyrjen dhe mbështetjen e institucioneve ndërkombëtare, duke siguruar respektimin e standardeve ndërkombëtare për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave demografike.

## **Regjistrimi i Popullsisë 2024**

Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë (ReKos), i realizuar në periudhën 5 prill - 24 maj 2024, përfaqëson një pikë kyçe në sistemin statistikor të vendit. Ky ishte regjistrimi i dytë pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe regjistrimi i parë që u realizua plotësisht në format digjital, duke kontribuar në mbledhjen dhe analizën e të dhënave me standarde të avancuara teknologjike. Ky regjistrim ka për qëllim të korrigjojë mangësitë e të kaluarës dhe të sigurojë të dhëna të sakta për zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës.

### **Planifikimi dhe Konsultimi**

ReKos 2024 ishte planifikuar me kujdes të veçantë, duke ndjekur standardet ndërkombëtare dhe duke përfshirë konsultime të gjera me palët e interesuara. Ky proces ishte dizajnuar për të garantuar që të dhënat e mbledhura të jenë të sakta, të krahasueshme me regjistrimet e mëparshme dhe të përputhura me standardet e Bashkimit Evropian.

ReKos 2024 është përgatitur në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian të Statistikave (KES) dhe me Rregulloren e Parlamentit Evropian nr. 763/2008, e cila përcakton kërkesat për regjistrimet e popullsisë në vendet anëtare të BE-së. Ky harmonizim siguron që të dhënat e mbledhura nga Kosova të jenë të krahasueshme me ato të vendeve të tjera evropiane, duke përmbushur standardet e larta të cilësisë dhe saktësisë.

Në përgatitjen e ReKos 2024, ASK ka bashkëpunuar ngushtë me një gamë të gjerë institucionesh, përfshirë ministritë, institucionet ndërkombëtare si Eurostat, organizatat joqeveritare dhe përfaqësues të komuniteteve lokale. Konsultimet synuan të përcaktonin temat prioritare për regjistrim, duke përfshirë pyetjet thelbësore që lidhen me demografinë, arsimin, migracionin dhe punësimin.

Temat e përfshira në pyetësorët e ReKos 2024 janë zgjedhur me kujdes, duke marrë në konsideratë nevojat kombëtare dhe ndërkombëtare. Pyetësorët përfshijnë pyetje për strukturën familjare, kushtet e banimit, migracionin, statusin socio-ekonomik të qytetarëve dhe dëmet nga lufta. Hartimi i pyetësorëve për ReKos 2024 përfshiu disa faza të ndërlidhura, të cilat u trajtuan me kujdes maksimal. Një aspekt kyç i hartimit të pyetësorëve ishte angazhimi i palëve të interesuara. ASK bashkëpunoi me agjenci qeveritare, grupe etnike dhe fetare, organizata joqeveritare (OJQ), si dhe me organizata ndërkombëtare. Ky bashkëpunim synonte të sigurohej që pyetësi të pasqyrojë nevojat dhe interesat e të gjithë përdoruesve. Në këtë kuadër, ASK organizoi 87 takime të veçanta me shfrytëzuesit e të dhënave, duke përfshirë gjithashtu dy ngjarje të quajtura "Java e Regjistrimit" (Census Week), secila me një kohëzgjatje prej pesë ditësh. Këto aktivitete u zhvilluan me qytetarët dhe palët e tjera të interesuara për të siguruar që të gjithë kishin mundësinë të jepnin kontributin e tyre.

Pyetësi i vitit 2024 u përmirësua ndjeshëm krahasuar me regjistrimin e fundit të popullsisë së vitit 2011. Përmbajtja e tij u zgjerua me 20% më shumë pyetje dhe nënpyetje, duke përfshirë një gamë më të gjerë temash. Kjo rritje e përmbajtjes synonte të sigurojë të dhëna më të hollësishme dhe të dobishme për politikën dhe planet e zhvillimit.

Për të garantuar përfshirje maksimale dhe qasje të barabartë për të gjitha grupet e popullsisë, pyetësi është hartuar dhe shpërndarë në shqip, serbisht, turqisht dhe anglisht. Kjo shumëgjuhësi reflekton diversitetin kulturor dhe etnik të Kosovës, duke siguruar që çdo individ të mund të plotësojë pyetësin në gjuhën e tij të parapëlqyer.

Regjistrimi i Popullsisë 2024 përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt përmbushjes së kushteve për anëtarësim në BE. Ky proces tregon aftësinë e Kosovës për të përmbushur detyrimet e saj ndërkombëtare dhe për të ofruar të dhëna të besueshme që do të ndihmojnë në zhvillimin e saj socio-ekonomik dhe politik. Si i tillë, ReKos 2024 është jo vetëm një proces teknik, por edhe një gur themel për të ardhmen e Kosovës në skenën evropiane.

## **Planifikimi dhe Përgatitja**

Planifikimi për Regjistrimin filloi që në vitin 2019. Kjo fazë u shoqërua me krijimin e një grupi pune të dedikuar, i cili kishte për qëllim mbikëqyrjen e të gjitha aspekteve të përgatitjes dhe përfshiu një gamë të gjerë masash dhe mekanizmash që siguruan një qasje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse. Ky grup kishte detyrën e sigurimit që metodologjitë e përzgjedhura, procedurat logjistike dhe rregullimet ligjore përmbushnin standardet më të larta. Faza përgatitore gjithashtu përqendrohej në identifikimin e sfidave të mundshme dhe në përgatitjen e skenarëve për t'i adresuar ato me efektivitet. Kështu, plani për Regjistrimin nuk ishte vetëm një përpjekje administrative, por një operacion strategjik, i mbështetur nga qasja metodologjike e bazuar në parimet shkencore të menaxhimit të projekteve.

Në aspektin metodologjik, grupi i punës përgatiti plane të detajuara të veprimit që adresonin çdo aktivitet.

## **Komponentët kryesorë të planifikimit**

**Plani i Detajuar i Veprimit:** Një nga komponentët kryesorë të planifikimit ishte hartimi i një plani të detajuar veprimi. Ky plan, që përfshinte një hartë rrugore gjithëpërfshirëse, kishte për qëllim të orientonte aktivitetet në sektorë të ndryshëm. Plani përbëhej nga mbi 500 aktivitete, të ndara në njësi dhe sektorë të ndryshëm. Fleksibiliteti i tij reflektohej në përditësimet e vazhdueshme për të pasqyruar ndryshimet që ndodhnin në mjedisin operacional. Shembulli domethënës i këtij fleksibiliteti ishte përballja me sfidat e pandemisë COVID-19, që detyroi rishikimin dhe përshtatjen e procedurave ekzistuese në përputhje me realitetin e ri.

**Menaxhimi i Rrezikut:** Ky ishte një komponent kyç në sigurinë e suksesit të projektit. Përfshinte zhvillimin e planeve emergjente për të minimizuar ndikimin e çdo sfide të paparashikuar që mund të pengonte procesin. Ky lloj menaxhimi u bë baza për zbatimin e politikave të përshtatura në çdo fazë, duke siguruar që operacionet të vazhdonin pa ndërprerje. Duke qenë se regjistrimi përfshinte një numër të madh sfidash të jashtme, u zhvilluan strategji të veçanta për përballimin e situatave emergjente. Identifikimi dhe vlerësimi i rrezikut ndihmuan në parashikimin e sfidave të mundshme dhe hartimin e skenarëve të përshtatshëm për secilën situatë. Këto plane emergjente ishin të dizajnuara për të minimizuar ndikimin e ngjarjeve të papritura dhe për të garantuar që procesi i regjistrimit të vazhdonte pa ndërprerje.

## **Testet regjistruese dhe regjistrimi Pilot**

Testet regjistruese dhe regjistrimi pilot janë faza thelbësore për përgatitjen dhe realizimin me sukses të një regjistrimi kombëtar.

## **Testet regjistruese**

Testet regjistruese u zhvilluan brenda ASK-së për të vlerësuar aplikacionet e grumbullimit të të dhënave, sistemet e TI-së dhe procedurat teknike. Aktivitetet kryesore përfshinë:

- Zhvillimi dhe testimi i aplikacioneve për grumbullim të të dhënave duke përdorur metodën CAPI.
- Testimi i pajisjeve elektronike për qëndrueshmëri dhe performancë në kushte reale të përdorimit.

### **Testet regjistruese**

Testet regjistruese u kryen në zona të zgjedhura në mënyrë të rastësishme për të reflektuar diversitetin demografik dhe gjeografik të vendit. Aktivitetet përfshinë:

- Trajnimi i anketuesve për përdorimin e aplikacioneve dhe procedurave të intervistimit.
- Zhvillimi i intervistave në terren për të vlerësuar rrjedhshmërinë dhe kohëzgjatjen e procesit të intervistimit.
- Monitorimi dhe mbikëqyrja e intervistave për të siguruar cilësinë e të dhënave të grumbulluara.

### **Regjistrimi Pilot**

Regjistrimi pilot u realizua në një numër të kufizuar komunash për të simuluar në mënyrë reale procesin e regjistrimit. Ky proces përfshiu:

- Grumbullimi i të dhënave të plota duke përdorur metodën CAPI.
- Mbledhja dhe verifikimi i të dhënave në kohë reale përmes sistemeve të integruara të TI-së.
- Logjistika dhe organizimi i shpërndarjes së pajisjeve, materialeve dhe stafit mbështetës në terren.
- Harta digjitale e përditësuar për të siguruar shpërndarjen e saktë të zonave të intervistimit dhe shpërndarjen e detyrave.
- Vlerësimi i rezultateve për të identifikuar çdo dobësi të mundshme në procedurat operative, teknike dhe administrative.

### **Metodologjia**

ASK zgjodhi metodologjinë CAPI për regjistrimin e popullsisë. Kjo qasje synoi të sigurote saktësi të lartë të të dhënave dhe një proces të standardizuar mbledhjeje, të bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare.

### **Intervista ballë për ballë dhe metoda CAPI**

Intervistat ballë për ballë ishin thelbësore për regjistrimin e të dhënave, duke lejuar regjistruesit të ndërveprojnë drejtpërdrejt me të intervistuarit. Kjo metodë siguroi që çdo pyetje të shpjegohej qartë dhe të gjitha përgjigjet të regjistroheshin saktësisht në aplikacionin CAPI. Teknologjia CAPI mundësoi futjen automatike të të dhënave në pajisje elektronike si tabletë dhe laptopë, duke përmirësuar procesin dhe duke ulur gabimet e mundshme që lidhen me regjistrimin manual. Të dhënat e mbledhura në terren transferoheshin në kohë reale në serverët qendrorë të sigurt për verifikim dhe përpunim të mëtejshëm.

### **Roli i regjistruesve dhe mbikëqyrësve**

Regjistruesit ishin përgjegjës për mbledhjen e të dhënave në terren, duke kryer intervista të strukturuar me qytetarët. Ata morën trajnime të specializuara për përdorimin e aplikacionit CAPI dhe protokollin e mbledhjes së të dhënave.



Mbikëqyrësit ishin përgjegjës për monitorimin e performancës së regjistruarve dhe sigurimin e respektimit të standardeve të cilësisë. Ata kryen kontroll të rregullt të të dhënave të mbledhura dhe raportuan çdo problem teknik ose operacional në qendrat përkatëse.

### **Qendrat e kontrollit dhe përpunimit (ASK)**

Të dhënat e mbledhura transferoheshin në qendrën e ASK-së për kontroll dhe përpunim. Kjo qendër ishte e pajisur me infrastrukturë të avancuar teknologjike dhe ekepe të specializuara për përpunimin e të dhënave, duke siguruar që çdo fazë e procesit të ishte transparente dhe besueshme.

ASK zhvilloi gjithashtu disa sisteme dhe panele kontrolli (dashboard) për monitorimin dhe identifikimin e anomalive gjatë procesit të regjistrimit. Këto sisteme ndihmuan në detektimin e devijimeve nga standardet e pritshme të të dhënave dhe mundësuan ndërhyrje të shpejta për të korrigjuar gabimet ose për të adresuar çështje teknike në kohë reale.

### **Fushata Publicitare**

#### **Fushata e komunikimit dhe ndërgjegjësimi të Publikut**

Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave 2024 varej jo vetëm nga përgatitja teknike dhe operacionale, por edhe nga informimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për rëndësinë dhe format e pjesëmarrjes në këtë proces. Për këtë arsye, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) zhvilloi dhe implementoi një fushatë gjithëpërfshirëse të komunikimit dhe sensibilizimit të publikut, e cila synonte të informojë dhe mobilizojë të gjithë qytetarët e Kosovës. Duke qenë një projekt me përmasa të mëdha dhe ndikim të gjerë, fushata e komunikimit dhe sensibilizimit të publikut ka luajtur një rol kyç në përgatitjen dhe realizimin e tij. Nëpërmjet një strategjie të strukturuar mirë dhe aktiviteteve gjithëpërfshirëse, kjo fushatë siguroi që qytetarët të jenë të informuar, të angazhuar dhe të ndërgjegjësuar për rëndësinë e pjesëmarrjes në proces.

#### **Objektivat e fushatës**

Fushata e komunikimit dhe sensibilizimit për ReKos 2024 ka pasur disa objektiva kryesore:

- Informimi i qytetarëve për rëndësinë dhe procesin e Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave.
- Nxitja e pjesëmarrjes aktive nga të gjitha grupet shoqërore dhe etnike, përfshirë komunitetet e marginalizuara dhe diasporën.
- Sigurimi i transparencës për procesin e regjistrimit dhe ndërtimi i besimit publik ndaj institucioneve përgjegjëse.
- Krijimi i një platforme komunikimi për të adresuar pyetjet dhe shqetësimet e qytetarëve në kohë reale.

#### **Platformat dhe kanalet e informimit**

ASK ka përdorur një gamë të gjerë platformash dhe kanalesh për të siguruar që mesazhet e fushatës të arrijnë çdo qytetar të Kosovës, duke përfshirë:

- **Faqe të dedikuara interneti:** Në kuadër të faqes zyrtare të ASK-së, është krijuar një hapësirë (seksion) specifik për Regjistrimin e Popullsisë, e cila ofron informacione të

sakta, të shpejta dhe të plota për qytetarët, mediat dhe të gjithë të tjerët të përfshirë në proces.

- **Konferenca dhe debate publike:** Në mënyrë të rregullt, ASK ka organizuar konferenca javore, ku prezantoheshin sfidat dhe progresi i procesit. Këto ngjarje shërbyen gjithashtu si një platformë për t'u përgjigjur pyetjeve dhe shqetësimeve të mediave, duke promovuar transparencë të plotë.
- **Media:** Artikuj, intervista dhe video-mesazhe të transmetuara përmes mediave të shkruara, elektronike dhe rrjeteve sociale kanë qenë elemente kyçe të fushatës. Videot me personalitete të njohura, përfshirë Presidenten, Kryeministrin dhe figura të shquara nga fusha e kulturës, sportit dhe diasporës, nxitën përfshirjen masive të qytetarëve.
- **Ngjarje informuese në terren:** U organizuan mbi 160 ngjarje në të gjitha komunat e Kosovës, duke përfshirë shkolla, universitete, kolegje dhe institucione të tjera. Këto aktivitete ishin të përqendruara në ndërgjegjësimin e drejtpërdrejtë të qytetarëve.

### **Materiale informative dhe angazhimi kreativ**

Për të përforcuar mesazhin e fushatës, ASK shpërndau një sërë materialesh informuese, duke përfshirë:

- Fletëpalosje, postera dhe letra informuese.
- Reklama dhe mesazhe të personalizuar përmes rrjeteve sociale.
- Dërgimin e mesazheve informative në telefonat celularë të qytetarëve.

### **Mediat**

Një nga funksionet më të rëndësishme të mediave është përhapja e informacionit në mënyrë të shpejtë, të saktë dhe gjithëpërfshirëse. Në rastin e ReKos, mediat ishin përgjegjëse për të informuar qytetarët për qëllimin, rëndësinë dhe mënyrën e zhvillimit të Regjistrimit të Popullsisë. ASK bashkëpunoi ngushtë me të gjitha llojet e mediave, përfshirë ato të shkruara, elektronike dhe televizive. ASK arriti marrëveshje me dhjetë televizione për transmetimin e video-mesazheve informuese në katër gjuhë: shqip, serbisht, turqisht dhe rome. Përmes këtyre mesazheve, të cilat u transmetuan për tre muaj rresht, qytetarët nga të gjitha komunitetet u informuan për procedurat e regjistrimit dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në regjistrim.

### **Puna në terren**

Puna në terren gjatë regjistrimit të popullsisë ka qenë një proces kompleks dhe i organizuar me kujdes për të siguruar që të dhënat e mbledhura të jenë të sakta dhe gjithëpërfshirëse. Ky proces ka përfshirë një bashkëpunim të ngushtë midis ekipeve të ASK-së, intervistuesve në terren, mbikëqyrësve lokalë dhe institucioneve të tjera përkatëse.

Para fillimit të regjistrimit, intervistuesit u trajnuan gjerësisht për përdorimin e pajisjeve teknologjike dhe për zbatimin e metodave të intervistimit sipas standardeve ndërkombëtare. Pajisjet si tabletët dhe laptopët u pajisën me aplikacione të personalizuar për mbledhjen e të dhënave, të cilat lehtësuan procesin dhe rritën efikasitetin.

Një pjesë thelbësore e suksesit të procesit ishte organizimi i logjistikës. Pajisjet teknologjike, materialet ndihmëse dhe furnizimet e nevojshme u shpërndanë në mënyrë të koordinuar në të gjithë territorin e Kosovës. ASK ofroi asistencë teknike dhe operacionale për intervistuesit dhe mbikëqyrësit, duke garantuar një rrjedhë të pandërprerë të punës në terren.

Intervistuesit vizituan çdo familje dhe individ në të gjitha zonat urbane dhe rurale të Kosovës. Procesi përfshiu grumbullimin e të dhënave demografike, ekonomike dhe sociale përmes intervistave të drejtpërdrejta dhe përdorimit të hartave digjitale për të lokalizuar çdo njësi regjistrimi. Integrimi i Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS) mundësoi një mbulueshmëri të saktë dhe kontroll të vazhdueshëm të progresit.

Për të mbështetur procesin e regjistrimit, u përdorën rreth 3,500 tableta dhe 900 laptopë, të cilët u konfiguruan dhe përgatitën nga stafi i ASK-së. Tabletët u përdorën nga intervistuesit në terren për mbledhjen e të dhënave në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndërsa laptopët u përdorën për kontrollin e cilësisë, monitorimin dhe mbështetjen teknike nga mbikëqyrësit.

Gjatë gjithë procesit, qendra të veçanta mbështetëse siguruan asistencë teknike për intervistuesit dhe monitoruan në kohë reale përparimin e punës. Çdo problem teknik ose organizativ u adresua menjëherë për të garantuar që procesi të vijonte pa ndërprerje.

Pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave, informacioni i regjistruar iu nënshtrua një procesi të detajuar të kontrollit dhe verifikimit për të eliminuar gabimet dhe për të plotësuar të dhënat e mungueshme. Kjo fazë siguroi që të dhënat e përfunduara të ishin të sakta dhe të besueshme për analizë dhe publikim.

### **Anketimi Pas Regjistrimit (APR)**

Regjistrimi i popullsisë është operacioni më i shtrenjtë dhe përbëhet nga një seri hapash të ndërlidhur më kompleksë në sistemin kombëtar statistikor. Është pranuar botërisht se regjistrimi i popullsisë nuk është i përsosur dhe se gabime mund të ndodhin dhe ndodhin në të gjitha fazat e operacionit të regjistrimit. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka kryer Anketën Pas Regjistruese (APR), për të vlerësuar shkallën e mbulimit dhe gabimeve në përmbajtje në Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave të Kosovës 2024, siç rekomandohet nga Parimet dhe Rekomandimet e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë. APP-ja e Kosovës është zhvilluar plotësisht në përputhje me udhëzimet ndërkombëtare për Anketën Pas Regjistruese. Anketa u zhvillua duke zbatuar parimin e pavarësisë nga procesi i regjistrimit. Objektivi kryesor i APR-së ishte që të matet niveli i mbulueshmërisë nacionale (nën numërimi dhe mbi-numërimi) si dhe gabimet në përmbajtje në regjistrimin e ReKos 2024. Gabimet në rezultatet e regjistrimit klasifikohen në dy kategori të përgjithshme - gabime në mbulim dhe gabime në përmbajtje. Gabimet e mbulimit janë gabimet që lindin për shkak të lëshimeve ose dyfishimeve të personave ose njërive të banimit në regjistrimin e regjistrimit. Pyetësi i APR-së 2024 përfshin pyetje për të përcaktuar nëse çdo person i ri-intervistuar i përket popullsisë së synuar të regjistrimit dhe përcaktimin e vendbanimit të secilit person në kohën e regjistrimit. Pyetësi mbledh informacion në lidhje me karakteristikat demografike të çdo individit për të matur gabimin e përgjigjes. Vlerësimet janë bazuar në metodologjinë e Vlerësimit të Sistemit të Dyfishtë (DSE). Bazuar në të gjeturat nga APR, të dhënat nga regjistrimi janë të besueshme, të plota dhe gjithëpërfshirëse. Një raport i gjerë i veçantë për APR është i disponueshëm në faqen e ASK-së.

### **Gjithpërfshirja dhe cilësia e të dhënave**

Sigurimi i mbulimit të plotë dhe ruajtja e cilësisë së lartë të të dhënave përbënin përparësi kyçe për ASK-në gjatë procesit të Regjistrimit. Ky proces ishte thelbësor për të garantuar që të dhënat demografike dhe sociale të jenë të plota dhe të sakta, duke përfaqësuar të gjitha komunitetet dhe zonat gjeografike të vendit. Megjithëse Regjistrimi përballoi sfida të ndryshme,

përfshirë kontekstin e brishtë politik në disa komuna veriore, ASK-ja arriti të sigurojë një mbulim të gjerë në të gjithë territorin e Kosovës. Përdorimi i strategjive inovative dhe teknologjive moderne luajti një rol kyç në tejkalimin e pengesave dhe sigurimin e cilësisë së të dhënave të grumbulluara. Një nga sukseset më të rëndësishme të Regjistrimit ishte arritja e mbulimit të mbi 99.8% të objekteve të banimit në Kosovë, pa përfshirë javën shtesë. Ky nivel i lartë mbulimi dëshmon për përkushtimin e ASK-së në sigurimin e përfaqësimit të drejtë të të gjithë popullsisë rezidente. Mbulimi kaq i gjerë ishte rezultat i vëzhgimit të rreptë dhe menaxhimit efektiv në terren, që mundësoi tejkalimin e vështirësive logjistike dhe politike në disa zona, sidomos në komunat veriore. Në këto zona, për shkak të tensioneve politike dhe bojkotimit nga komuniteti serb, mbulimi nuk ishte i plotë. Megjithatë, ASK-ja zhvilloi mekanizma shtesë për të reduktuar boshllëqet dhe për të siguruar që regjistrimi të përmbushte standardet ndërkombëtare për mbulimin statistikor. Gjithashtu, vlerësimi i mbarëvajtjes së procesit të Regjistrimit të Popullsisë u theksua veçanërisht nga misioni i UNFPA dhe UNECE në takimin me aktorët vendorë dhe ndërkombëtarë të mbajtur në fund të muajit prill 2024, ku nxori në pah disa konkluzione të rëndësishme:

- Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë 2024 u vlerësua si një proces i organizuar në nivel të lartë.
- Procesi ishte në përputhje të plotë me kriteret dhe standardet ndërkombëtare.
- ASK tregoi transparencë dhe profesionalizëm gjatë gjithë fazave të Regjistrimit.

Angazhimi i ekspertëve ndërkombëtarë ndikoi drejtpërdrejt në suksesin dhe legjitimitetin e ReKos 2024. Ekspertët siguruan që të gjitha aspektet e projektit të ishin në harmoni me praktikën më të mira globale, duke rritur besueshmërinë e të dhënave të regjistrimit. Vëzhgimi dhe vlerësimi i pavarur i ekspertëve ndërkombëtarë ndihmoi në ndërtimin e besimit të publikut dhe palëve të interesuara në rezultatet e regjistrimit. Përveç kësaj, ASK-ja zbatoi një strategji të diferencuar për regjistrimin në terren, duke angazhuar burime shtesë në ato zona ku pritej që mbulimi të ishte i vështirë. Kjo përfshinte përdorimin e ekipit të trajnuar mirë të intervistuesve dhe vëzhguesve, të cilët ishin të pajisur me njohuri të thella mbi sfidat lokale dhe ndjeshmëritë politike. Pavarësisht sfidave të natyrshme që lidhen me një proces të tillë, vlerësimet e deritanishme tregojnë se ky proces është zhvilluar me sukses dhe do të vazhdojë të ofrojë një bazë të fortë për të ardhmen.

### **Ndarja territoriale**

Në kuadër të përgatitjeve për ReKos 2024, një nga komponentët themelorë ishte edhe krijimi dhe përditësimi i Zonave të Regjistrimit (ZR). Këto zona përbënin bazën organizative për mbledhjen efikase, të saktë dhe gjithëpërfshirëse të të dhënave. Nëpërmjet përmirësimeve teknologjike dhe ndarjeve të strukturuar, ASK arriti të sigurojë një mbulim të plotë të territorit të vendit dhe një proces të standardizuar për Regjistrimin.

Zonat e regjistrimit janë ndarjet gjeografike që ndihmojnë në organizimin dhe shpërndarjen e burimeve për mbledhjen e të dhënave në terren. Hartimi i saktë dhe përditësimi i këtyre zonave është një proces i ndërlikuar, por jetik për garantimin e një regjistrimi të suksesshëm. Për ReKos 2024, ASK përditësoi mbi 5000 zona regjistrimi nga viti 2019 deri në vitin 2022, duke shtuar ndarje të reja dhe duke kodifikuar çdo objekt dhe ekonomi familjare. Ky përditësim mundësoi organizimin më të mirë të punës në terren dhe siguroi që asnjë objekt apo familje të mos mbetej pa u regjistruar.

## **TI-ja dhe GIS gjatë procesit të regjistrimit të Popullsisë në Kosovë**

Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit (TI) dhe Sistemeve të Informacionit Gjeografik (GIS) ka luajtur një rol vendimtar në modernizimin, automatizimin dhe sigurimin e saktësisë së të dhënave.

TI ka siguruar bazën teknike për menaxhimin e të dhënave, mbledhjen dhe përpunimin e tyre, përfshirë:

- Aplikacionet CAPI për mbledhjen e të dhënave
- Udhëzues të ndryshëm për Regjistruesit, Mbikëqyrësit dhe Qendrën
- Sistemi i Monitorimit
- Sistemi i Logjistikës
- Sistemi i Pagesave
- Validimi i të Dhënave
- Infrastruktura harduerike
- Siguria Kibernetike
- Faqja zyrtare e Regjistrimit
- Sistemet e backup-it, etj.

GIS është përdorur gjerësisht për krijimin dhe mirëmbajtjen e hartave dixhitale që mbulojnë të gjithë territorin e Kosovës. GIS ka ndihmuar në ndarjen e vendit në zona të regjistrimit, të cilat janë përdorur për të planifikuar dhe shpërndarë detyrat për regjistruesit, si dhe ka lejuar monitorimin e progresit të regjistrimit në kohë reale përmes pajisjeve mobile/tablet me GPS.

Gjithashtu, pas grumbullimit të të dhënave, GIS ka mbështetur analizën hapësinore për të identifikuar zona me përqendrim të larta ose të ulëta të popullsisë dhe për të hartuar raportet për vendimarrje.

### **Ndarjet zonale dhe kodifikimi i objekteve**

Një arritje tjetër e rëndësishme e këtij procesi ishte krijimi i ndarjeve të reja zonale dhe kodifikimi i objekteve. Secili objekt, pavarësisht madhësisë apo destinacionit të tij, iu dha një kod unik, që lehtësoi organizimin dhe saktësinë në regjistrim. Ky sistem kodifikimi:

- Siguroi që çdo objekt dhe ekonomi familjare të ishte e përfshirë në proces.
- Rriti efikasitetin në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave.
- Mundi të përballonte ndërlikueshmërinë e ndryshimeve në struktura dhe popullsi, duke krijuar një bazë të dhënash më të saktë dhe gjithëpërfshirëse.

### **Asistenca teknike ndërkombëtare**

Asistenca teknike ndërkombëtare përfshiu mbështetje të specializuar nga ekspertë të huaj dhe institucione ndërkombëtare që sollën përvojën e gjerë dhe njohuritë teknike për realizimin e proceseve të ndërlikuara të Regjistrimit të Popullsisë. Në këtë kontekst, ekspertët ndërkombëtarë ofruan asistencë në fushat kryesore si: projektimi i sistemeve dhe infrastrukturës teknologjike, menaxhimi i burimeve njerëzore, trajnimi i stafit, si dhe zhvillimi i metodologjive të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave.

Një aspekt i rëndësishëm i asistencës teknike ishte sigurimi i një mbështetjeje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës së implementimit të projektit. Regjistrimi i popullsisë nuk është një aktivitet që mund të përfundojë brenda një periudhe të shkurtër kohore. Ai kërkon mbikëqyrje, adaptim dhe përmirësim të vazhdueshëm të metodave dhe teknikave të përdorura.

Për shkak të mungesës së një definimi të qartë dhe të saktë të datës për Regjistrimin e Popullsisë, i cili zakonisht caktohet 2-3 vite përpara realizimit të tij si kusht për sigurimin e asistencës teknike ndërkombëtare, ASK nuk arriti të sigurojë mbështetje teknike ndërkombëtare për projektin. Gjatë vitit 2019 dhe 2020, ASK përfitoi nga asistenca teknike ndërkombëtare përmes misionëve të shkurtra (3-5 ditore), të cilat ishin të përqendruara në hartimin e disa dokumenteve strategjike dhe metodologjike. Kjo mbështetje ishte siguruar nga organizata si Eurostat, UNFPA dhe Banka Botërore.

Në buxhetin e parashikuar për projektin, ishte llogaritur një shumë prej rreth 1.2 milion euro për asistencë teknike ndërkombëtare, e cila përfshinte fushat e menaxhimit, metodologjisë, trajnimeve, komunikimit, teknologjisë së informacionit (IT), Sistemeve të Informacionit Gjeografik (GIS) dhe analizave. Megjithatë, për shkak të faktit që këto aktivitete u mbuluan nga stafi i brendshëm i ASK-së, këto fonde (1.2 milion euro) nuk u alokuan nga donatorët dhe, si pasojë, nuk u shfrytëzuan për asistencën teknike të planifikuar.

### **Shpërndarja e të dhënave**

ReKos 2024, si një proces i gjerë dhe i ndërlikuar, përfshin faza të shumta teknike dhe organizative që sigurojnë mbledhjen, verifikimin, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave, duke përmbytur standardet më të larta ndërkombëtare në këtë fushë. Një komponent thelbësor i këtij projekti është shpërndarja efektive dhe gjithëpërfshirëse e të dhënave, e cila synon të përmbyshë nevojat e përdoruesve të ndryshëm, duke përfshirë qeverinë, institucionet akademike, organizatat ndërkombëtare dhe qytetarët. Me një përkushtim të lartë ndaj transparencës, gjithëpërfshirjes dhe cilësisë, ky projekt do të sigurojë një pasuri të çmuar të dhënash për zhvillimin e ardhshëm të Kosovës dhe për fuqizimin e vendimmarrjes së bazuar në të dhëna.

Pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave në terren, ReKos 2024 kalon në fazën e përpunimit të të dhënave, ku sigurohet cilësia dhe integriteti i tyre. Gjatë kësaj periudhe, të dhënat do të kontrollohen për të siguruar saktësinë dhe qëndrueshmërinë midis burimeve të ndryshme. Më pas, përdoren metoda statistikore për të plotësuar të dhënat e paqasshme ose të paplota, duke garantuar që rezultati final të reflektojë realitetin. Dhe, në fund, zbatohen protokolle të rrepta për të garantuar që të dhënat përmbyshin standardet më të larta ndërkombëtare.

Shpërndarja e të dhënave nga ReKos 2024 do të bëhet përmes kanaleve të ndryshme që synojnë të fuqizojnë qasjen për të gjitha grupet e interesuara. Raporte të detajuara, që përfshijnë analizën e popullsisë, strukturës demografike, karakteristikat ekonomike dhe banesat, do të publikohen në formë të shtypur. Këto dokumente do të shpërndahen në institucionet qendrore dhe lokale, biblioteka, organizata akademike dhe media për të siguruar një qasje të gjerë dhe gjithëpërfshirëse. Përveç kësaj, të gjithë të interesuarit do të kenë mundësi qasjeje në platformën digjitale interaktive, e cila do të jetë në dispozicion të publikut. Kjo platformë do t'u mundësojë përdoruesve të kërkojnë dhe të personalizojnë të dhënat sipas parametrave të ndryshëm, të tillë si mosha, gjinia, statusi ekonomik, vendbanimi dhe të tjerë. Të dhënat, po ashtu, do të jenë të disponueshme për t'u shkarkuar në formate të përdorshme si PDF dhe Excel, duke lehtësuar analizat e mëtejshme dhe përdorimin për qëllime kërkimore, planifikimi dhe politikëbërjeje.

Duke pasur parasysh diversitetin gjuhësor të Kosovës dhe nevojën për të komunikuar me audiencën ndërkombëtare, të gjitha publikimet dhe të dhënat do të jenë të disponueshme në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht, duke siguruar qasje të barabartë për të gjithë.

Shpërndarja e të dhënave nga ReKos 2024 ka për qëllim të sigurojë një bazë të fortë për vendimmarrje të bazuar në të dhëna, nxitjen e kërkimeve shkencore dhe rritjen e transparencës publike. Rezultatet e Regjistrimit do të jenë një burim thelbësor për hartimin e



politikave qeveritare në fusha të tilla si arsimi, shëndetësia, zhvillimi urban dhe mirëqenia sociale, duke siguruar që politikat publike të mbështeten në të dhëna të sakta dhe të përditësuara. Institucionet akademike dhe kërkimore do të kenë mundësinë të përdorin të dhënat për të kryer analiza të thelluara në fusha të ndryshme, si demografia, ekonomia, zhvillimi social, etj.

Të dhënat do të jenë të qasshme pa pagesë për të gjithë qytetarët, duke rritur kështu transparencën dhe duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes dhe diskutimet publike mbi zhvillimin e vendit.

### **Platforma të avancuara për shpërndarjen e të dhënave**

ASK do të bëjë shpërndarjen online të të dhënave përmes një infrastrukture të avancuar teknologjike që garanton transparencën, qasjen dhe përdorimin e statistikave zyrtare nga publiku dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo do të arrihet duke përdorur një qasje të integruar që kombinon disa platforma dhe teknologji moderne.

**ASKdata:** është një platformë dixhitale e zhvilluar nga ASK për të mundësuar shpërndarjen e të dhënave statistikore në mënyrë interaktive. Kjo platformë ofron përdoruesve qasje të lehtë dhe të personalizuar në statistikave zyrtare, duke përfshirë: tabela statistikore interaktive, grafika dinamike, API të hapura për integrimin me sisteme të tjera, etj.

### **WebGIS për vizualizimin e të dhënave gjeohapësinore:**

WebGIS është një sistem që mundëson vizualizimin hapësinor të të dhënave statistikore dhe përdoret për të ndihmuar në procesin e regjistrimit të popullsisë. Përmes WebGIS, të dhënat e regjistrimit të popullsisë mund të shfaqen në harta interaktive, duke përfshirë: shfaqje interaktive të hartave me lokacione të njësive të regjistrimit, integrimin e të dhënave të regjistrimit dhe statistikave të tjera.

### **Publikimet dhe Metadata:**

ASK do të publikojë publikime të veçanta tematike dhe do të bëjë dokumentimin e procesit të regjistrimit përmes sistemit të metadatave SIMS 2.0, si: sqarime mbi përdorimin dhe kufizimet e të dhënave për të siguruar transparencë dhe qartësi, kufizimet dhe interpretimet, harmonizimi i të dhënave sipas standardeve ndërkombëtare, etj.

### **Formati SDMX për shkëmbimin e të dhënave:**

Formati SDMX (Statistical Data and Metadata Exchange) është një standard ndërkombëtar për shkëmbimin e të dhënave statistikore ndërmjet institucioneve. Përfitimet kryesore të përdorimit të SDMX përfshijnë:

- Sigurimin e një formati të unifikuar që lehtëson shkëmbimin ndërkombëtar të të dhënave.
- Procesi i shkëmbimit të të dhënave bëhet më i shpejtë dhe më pak i ndërlikuar për shkak të integritetit të automatizuar.
- Standardizimi dhe automatizimi minimizojnë mundësinë e gabimeve gjatë shkëmbimit të të dhënave.

### **eDAMIS për shkëmbimin e të dhënave me Eurostat:**

Është një platformë e përdorur nga Eurostat për shkëmbimin e të dhënave statistikore. Përfitimet e përdorimit të eDAMIS përfshijnë:

- Të dhënat statistikore dërgohen në mënyrë të sigurt dhe të koduar.
- Kosova përmbush detyrimet e saj të raportimit ndaj Eurostat.
- Mbështetje për certifikimin dhe monitorimin e cilësisë së të dhënave të dorëzuara.

### **Kërkesa për të dhëna specifike**

Duke qenë se të dhënat e ReKos 2024 përfshijnë informacione të ndjeshme, ato trajtohen me nivelin më të lartë të konfidencialitetit.

Bazuar në Ligjin për Statistikat Zyrtare, Ligjin për Regjistrimin e Popullsisë dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të dhënat e mbledhura nga ReKos 2024 janë të dhëna konfidenciale. Kjo nënkupton që çdo informacion që mund të identifikojë individët apo familjet nuk mund të bëhet publik ose të përdoret për qëllime jashtë atyre të miratuara me ligj. ASK garanton se të gjitha të dhënat përpunohen në përputhje me këto ligje dhe udhëzimet përkatëse, duke ruajtur kështu integritetin dhe privatësinë e çdo individ.

ASK ka përcaktuar një proces të qartë për paraqitjen e kërkesave për të dhëna specifike: përdoruesit duhet të paraqesin një kërkesë të dokumentuar zyrtarisht, ku përshkruhet qartë qëllimi i përdorimit të të dhënave, lloji i të dhënave të kërkuara dhe analiza që pritet të kryhet. Pas dorëzimit, kërkesa shqyrtohet nga ekipi i ASK-së për të siguruar që të dhënat e kërkuara nuk shkelin asnjë rregull mbi konfidencialitetin dhe janë në përputhje me qëllimet e lejuara të përdorimit. Në fund, ASK përgatit të dhënat e kërkuara duke i anonimizuar ato dhe duke siguruar që asnjë informacion që mund të identifikojë individë të veçantë nuk është i përfshirë. Vetëm të dhënat e përgjithshme/mbledhura mund të dorëzohen.

Për të siguruar që çdo përpunim i të dhënave të personalizuara të ndjekë standardet më të larta të etikës dhe sigurisë, ASK ka lëshuar një sërë udhëzimesh dhe procedurash që duhet të respektohen nga të gjithë përdoruesit e të dhënave. Këto udhëzime përfshijnë detaje mbi mënyrat e anonimizimit të të dhënave, kufizimet mbi përdorimin e tyre dhe raportimin e rezultateve përfundimtare të analizave të kryera.

Kërkesat për të dhëna specifike luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e kërkimeve shkencore, zhvillimin e politikave publike dhe përmirësimin e vendimmarrjes në fusha të ndryshme. ASK mbetet e përkushtuar që të balancojë transparencën dhe konfidencialitetin në trajtimin e të dhënave të ReKos 2024. Përmes një procesi të rregulluar për kërkesat për të dhëna specifike, ASK siguron që të dhënat e mbledhura të përdoren për qëllime të dobishme dhe me vlerë për shoqërinë, pa cenuar të drejtën për privatësi të individëve.

# KAPITULLI 2

## TABELAT PËRMBLEDHËSE (tabelat në nivel kombëtar)

Tab. 2.1 – Popullsia rezidente dhe ekonomitë familjare

POPULLSIA REZIDENTE DHE EKONOMITË FAMILJARE	VITET	
	2011	2024
<b>Popullsia e përgjithshme</b>	<b>1 739 825</b>	<b>1 585 566</b>
Meshkuj	875 900	795 552
Femra	863 925	790 014
Raporti gjinor	101.40	100.70
<b>Popullsia urbane</b>	<b>661 586</b>	<b>795 627</b>
% e popullsisë urbane	38.03	50.18
<b>Popullsia rurale</b>	<b>1 078 239</b>	<b>789 939</b>
% e popullsisë rurale	61.97	49.82
<b>Popullsia nën moshën 6 vjeç</b>	<b>179 648</b>	<b>153 691</b>
% e popullsisë nën moshën 6 vjeç në popullsinë e përgjithshme	10.30	9.69
<b>Popullsia e moshës 65 vjeç +</b>	<b>116 785</b>	<b>173 875</b>
% e popullsisë së moshës mbi 65 vjeç në popullsinë e përgjithshme	6.70	10.97
<b>Popullsia e moshës 15 - 64</b>	<b>1 135 463</b>	<b>1 063 687</b>
% e popullsisë së moshës 15-64	65.26	67.09
<b>Popullsia e moshës 75 +</b>	<b>38 922</b>	<b>59 163</b>
% e popullsisë së moshës 75 + në popullsinë e përgjithshme	2.20	3.73
<b>Popullsia e mbajtur: 0 -14 dhe 65+</b>	<b>604 362</b>	<b>521 879</b>
% e popullsisë së mbajtur 0-14 dhe 65+	34.74	32.91
<b>Numri i ekonomive familjare</b>	297 090	366 595
<b>Numri mesatar i personave për ekonomi familjare</b>	5.90	4.33

Tab. 2.2 – Arsimimi

ARSIMI - NIVELI MË I LARTË I PËRFUNDUAR	VITET	
	2011	2024
<b>Popullsia e moshës 10 vjeç e më shumë</b>	<b>1 429 174</b>	<b>1 360 584</b>
<i>Meshkuj të moshës 10 vjeç e më shumë</i>	715 059	677 780
<i>Femra të moshës 10 vjeç e më shumë</i>	714 115	682 804
<b>Popullsia me arsim të lartë të përfunduar</b>	<b>116 912</b>	<b>233 559</b>
<i>% e popullsisë së moshës 10 vjeç e më shumë me arsim të lartë të përfunduar</i>	8.18	17.17
<i>% e femrave në mesin e të diplomuarve</i>	3.02	8.64
<b>Popullsia me arsim të mesëm të lartë të përfunduar</b>	<b>427 905</b>	<b>475 809</b>
<i>% e popullsisë me shkollë të mesme, të lartë në popullsinë e moshës mbi 10 vjeç</i>	29.94	34.97
<i>% e femrave në mesin e popullsisë me shkollë të mesme, të lartë</i>	10.72	13.05
<b>Popullsia me arsim të mesëm të ulët të përfunduar</b>	<b>501 617</b>	<b>389 030</b>
<i>% e popullsisë me shkollë të mesme, të ulët në popullsinë e moshës 10 vjeç e më shumë</i>	35.10	28.59
<i>% e femrave në mesin e popullsisë me shkollë të mesme, të ulët</i>	20.14	16.68
<b>Popullsia me arsim fillor të përfunduar</b>	<b>245 552</b>	<b>186 020</b>
<i>% e popullsisë me shkollë fillore në popullsinë e moshës 10 vjeç e më shumë</i>	17.18	13.67
<i>% e femrave në popullsinë me shkollë fillore (me sistem të ri dhe me të vjetër)</i>	9.98	8.28
<b>Tjeter</b>	:	<b>5 831</b>
<i>% e popullsisë me shkollim tjetër</i>	:	0.43
<i>% e femrave me shkollim tjetër</i>	:	0.20
<b>Popullsia pa arsim formal/ pa nivel të përfunduar të arsimimit që dinë shkrim-lexim</b>	<b>82 188</b>	<b>24 408</b>
<i>% e popullsisë pa arsim formal/nuk e kanë përfunduar nivelin e arsimimit të të mësuarit të shkrim-leximit</i>	5.75	1.79
<i>% e femrave në mesin e popullsisë pa arsim formal/nuk e kanë përfunduar nivelin e arsimimit të të mësuarit të shkrim-leximit</i>	3.06	1.13
<b>Numri i përgjithshëm i popullsisë analfabete</b>	<b>55 001</b>	<b>30 902</b>
<i>% e analfabetëve në popullsinë e moshës 10 vjeç e më shumë</i>	3.85	2.27
<i>% e femrave në mesin e analfabetëve</i>	79.70	73.58
<b>Të pa deklaruar</b>	:	<b>15 025</b>

**Tab. 2.3 – Ndërtesat dhe Banesat**

NDËRTESTAT DHE BANESAT	VITET	
	2011	2024
Numri i ndërtesave për banim	<b>340 945</b>	<b>414 273</b>
Numri mesatar i banesave për ndërtesë	1.30	1.41
<b>Numri i banesave të përgjithshme</b>	<b>412 884</b>	<b>583 560</b>
<b>Numri i banesave të zakonshme (të shfrytëzuara)</b>	<b>412 519</b>	<b>556 779</b>
<i>E shfrytëzuar nga një ose më shumë banorë të zakonshëm</i>	293 078	356 959
<i>E shfrytëzuar nga banorë që nuk përfshihen në regjistrim (Personeli diplomatik)</i>	1 083	590
<i>E rezervuar për qëndrim sezonal/shfrytëzim të rastit (pushime, punë sezonale)</i>	18 550	16 381
Numri i banesave të zbrazëta	99 808	182 849
<b>Numri i njësive tjera të banimit</b>	<b>365</b>	<b>26 781</b>
Numri mesatar i ekonomive familjare për banesë/shtëpi	1.0	1.03
Numri mesatar i banorëve për banesë/shtëpi	4.22	2.85
Numri mesatar i dhomave për banesë	4.0	4.06
Mesatarja e hapësirës së shfrytëzueshme për banorë m <sup>2</sup>	13.3	20.41

**Tab. 2.4 – Popullsia sipas gjinisë dhe vitit të regjistrimit**

VITI	GJINIA				
	Gjithsej	Femra	%	Meshkuj	%
1921	439 010	218 766	49.83	220 244	50.17
1931	552 064	271 208	49.13	280 856	50.87
1948	733 034	359 298	49.02	373 736	50.98
1953	815 908	399 370	48.95	416 538	51.05
1961	963 988	471 358	48.90	492 630	51.10
1971	1 243 693	606 735	48.78	636 958	51.22
1981	1 584 440	766 048	48.35	818 392	51.65
2011	1 739 825	863 925	49.66	875 900	50.34
2024	1 585 566	790 014	49.83	795 552	50.17

**Tab. 2.5 – Popullsia sipas grupmoshës dhe vitit të regjistrimit**

GRUPMOSHA	VITI				
	1961	1971	1981	2011	2024
0-4	165 881	208 729	235 912	149 735	107 710
5-9	131 868	172 997	221 376	160 916	117 272
10-14	108 517	149 031	198 699	176 926	123 022
15-19	87 286	126 202	172 284	174 932	122 613
20-24	83 650	100 431	140 052	161 467	134 270
25-29	74 293	80 028	111 499	141 268	113 474
30-34	64 160	76 792	92 034	130 542	109 335
35-39	43 491	68 925	76 214	124 912	103 883
40-44	35 107	58 907	73 758	108 142	103 224
45-49	34 333	38 690	64 328	94 988	105 345
50-54	36 619	32 599	55 533	80 625	100 167
55-59	27 534	32 234	35 975	65 539	91 084
60-64	25 587	32 425	29 302	53 048	80 292
65+	44 796	55 559	68 701	116 785	173 875
Të panjohur	866	10 144	8 773	:	:
<b>Gjithsej</b>	<b>963 988</b>	<b>1 243 693</b>	<b>1 584 440</b>	<b>1 739 825</b>	<b>1 585 566</b>

**Tab. 2.6 – Treguesit e strukturës së moshës sipas vitit të regjistrimit**

TREGUESIT E STRUKTURËS SË MOSHËS	VITI				
	1961	1971	1981	2011	2024
Raporti i plakjes	11 03	10 47	10 47	23 95	49 96
Raporti i varësisë	87 92	89 19	84 29	53 23	49 06
% e femrave në mesin e popullsisë së moshës 65+	44 8	52 6	53 8	53 25	52 65
% e femrave në mesin e popullsisë së moshës 75+	:	:	:	56 5	54 57

# KAPITULLI 3

## POPULLSIA, EKONOMITË FAMILJARE DHE NJËSITË E BANIMIT

(Tabelat në nivel kombëtar)

Tab. 3.1 – Popullsia rezidente në Kosovë sipas gjinisë dhe moshës së vetme

MOSHA	GJINIA		
	Gjithsej	Femra	Meshkuj
0	20 467	9 686	10 781
1	21 461	10 296	11 165
2	22 420	10 762	11 658
3	21 255	10 150	11 105
4	22 107	10 425	11 682
5	22 868	10 944	11 924
6	23 113	10 931	12 182
7	23 403	11 136	12 267
8	23 599	11 302	12 297
9	24 289	11 578	12 711
10	24 615	11 674	12 941
11	24 574	11 719	12 855
12	24 989	12 129	12 860
13	24 485	11 778	12 707
14	24 359	11 653	12 706
15	24 553	11 821	12 732
16	24 583	11 678	12 905
17	23 892	11 521	12 371
18	24 433	11 926	12 507
19	25 152	12 305	12 847
20	25 060	12 268	12 792
21	26 347	12 919	13 428
22	27 358	13 394	13 964
23	31 686	15 226	16 460
24	23 819	11 352	12 467
25	22 914	10 986	11 928
26	22 909	11 007	11 902
27	23 036	11 125	11 911
28	22 549	10 746	11 803
29	22 066	10 829	11 237
<b>Gjithsej 0-29</b>	<b>718 361</b>	<b>345 266</b>	<b>373 095</b>

Tab. 3.1 – Popullsia rezidente në Kosovë sipas gjinisë dhe moshës së vetme

(vazhdim)

MOSHA	GJINIA		
	Gjithsej	Femra	Meshkuj
30	22 160	10 749	11 411
31	22 216	10 802	11 414
32	22 044	10 912	11 132
33	21 449	10 622	10 827
34	21 466	10 541	10 925
35	21 113	10 489	10 624
36	21 234	10 394	10 840
37	21 001	10 386	10 615
38	20 644	10 251	10 393
39	19 891	9 740	10 151
40	20 775	10 373	10 402
41	20 655	10 218	10 437
42	20 706	10 193	10 513
43	20 552	10 171	10 381
44	20 536	10 359	10 177
45	20 475	10 509	9 966
46	20 800	10 867	9 933
47	20 946	11 011	9 935
48	21 822	11 333	10 489
49	21 302	11 157	10 145
50	20 332	10 567	9 765
51	20 382	10 823	9 559
52	20 163	10 562	9 601
53	19 115	10 276	8 839
54	20 175	10 791	9 384
55	18 807	10 021	8 786
56	18 750	9 862	8 888
57	17 893	9 382	8 511
58	17 879	9 245	8 634
59	17 755	9 232	8 523
<b>Gjithsej 30-59</b>	<b>613 038</b>	<b>311 838</b>	<b>301 200</b>



Tab. 3.1 – Popullsia rezidente në Kosovë sipas gjinisë dhe moshës së vetme

(vazhdim)

MOSHA	GJINIA		
	Gjithsej	Femra	Meshkuj
60	17 375	8 944	8 431
61	16 064	8 288	7 776
62	16 016	8 259	7 757
63	16 135	8 369	7 766
64	14 702	7 502	7 200
65	15 173	7 743	7 430
66	12 843	6 516	6 327
67	13 254	6 789	6 465
68	12 339	6 214	6 125
69	12 691	6 593	6 098
70	11 095	5 607	5 488
71	10 806	5 619	5 187
72	8 738	4 580	4 158
73	9 285	4 986	4 299
74	8 488	4 618	3 870
75	7 351	3 971	3 380
76	7 047	3 798	3 249
77	6 373	3 372	3 001
78	5 303	2 783	2 520
79	5 309	2 849	2 460
80	4 705	2 550	2 155
81	4 358	2 408	1 950
82	3 285	1 757	1 528
83	3 257	1 717	1 540
84	2 672	1 470	1 202
85	2 016	1 132	884
86	1 717	944	773
87	1 482	824	658
88	1 149	709	440
89	921	539	382
90	644	420	224
91	497	334	163
92	328	189	139
93	235	161	74
94	201	132	69
95	125	81	44
96	66	48	18
97	39	28	11
98	18	13	5
99	15	13	2
100+	50	41	9
<b>Gjithsej 60 - 100+</b>	<b>254 167</b>	<b>132 910</b>	<b>121 257</b>

\*Sqarim: Moshja mesatare e popullsisë është 34.84, moshja mesatare e femrave 35.66 ndërsa e meshkujve 34.03.

Tab. 3.2 – Popullsia sipas grupmoshave, gjinisë dhe tipit të vendbanimit (urbane/rurale)

GRUPMOSHA		GJINIA		
		Gjithsej	Femra	Meshkuj
Gjithsej	0-4	107 710	51 319	56 391
	5-9	117 272	55 891	61 381
	10-14	123 022	58 953	64 069
	15-19	122 613	59 251	63 362
	20-24	134 270	65 159	69 111
	25-29	113 474	54 693	58 781
	30-34	109 335	53 626	55 709
	35-39	103 883	51 260	52 623
	40-44	103 224	51 314	51 910
	45-49	105 345	54 877	50 468
	50-54	100 167	53 019	47 148
	55-59	91 084	47 742	43 342
	60-64	80 292	41 362	38 930
	65-69	66 300	33 855	32 445
	70-74	48 412	25 410	23 002
	75-79	31 383	16 773	14 610
	80-84	18 277	9 902	8 375
	85+	9 503	5 608	3 895
	<b>Gjithsej</b>	<b>1 585 566</b>	<b>790 014</b>	<b>795 552</b>

Tab. 3.2 – Popullsia sipas grupmohave, gjinisë dhe tipit të vendbanimit (urbane/rurale)

(vazhdim)

GRUPMOSHA		GJINIA		
		Gjithsej	Femra	Meshkuj
Urban	0-4	54 846	25 938	28 908
	5-9	59 078	28 235	30 843
	10-14	60 029	28 972	31 057
	15-19	58 451	28 337	30 114
	20-24	64 968	31 654	33 314
	25-29	58 108	28 678	29 430
	30-34	57 754	29 162	28 592
	35-39	55 632	28 180	27 452
	40-44	54 489	27 322	27 167
	45-49	52 962	27 423	25 539
	50-54	48 400	25 834	22 566
	55-59	44 276	23 487	20 789
	60-64	39 788	20 979	18 809
	65-69	33 907	17 774	16 133
	70-74	24 621	13 066	11 555
	75-79	15 534	8 307	7 227
	80-84	8 575	4 606	3 969
	85+	4 209	2 433	1 776
		<b>Gjithsej</b>	<b>795 627</b>	<b>400 387</b>
Rural	0-4	52 864	25 381	27 483
	5-9	58 194	27 656	30 538
	10-14	62 993	29 981	33 012
	15-19	64 162	30 914	33 248
	20-24	69 302	33 505	35 797
	25-29	55 366	26 015	29 351
	30-34	51 581	24 464	27 117
	35-39	48 251	23 080	25 171
	40-44	48 735	23 992	24 743
	45-49	52 383	27 454	24 929
	50-54	51 767	27 185	24 582
	55-59	46 808	24 255	22 553
	60-64	40 504	20 383	20 121
	65-69	32 393	16 081	16 312
	70-74	23 791	12 344	11 447
	75-79	15 849	8 466	7 383
	80-84	9 702	5 296	4 406
	85+	5 294	3 175	2 119
		<b>Gjithsej</b>	<b>789 939</b>	<b>389 627</b>

**Tab. 3.3 – Popullsia rezidente e moshës 15 vjeç e mbi sipas gjinisë, tipit të vendbanimit (urbane/rurale) dhe statusit martesor**

STATUSI MARTESOR		GJINIA		
		Gjithsej	Femra	Meshkuj
Gjithsej	Asnjëherë i/e martuar	370 686	159 884	210 802
	I/e martuar me kurorë	679 946	343 961	335 985
	I/e martuar pa kurorë	89 531	46 249	43 282
	Bashkëjetesë	7 473	3 733	3 740
	I/e ndarë, por ligjërisht I/e martuar	1 560	980	580
	I/e shkurorezuar	9 928	5 776	4 152
	I/e ve	78 438	63 268	15 170
	<b>Gjithsej</b>	<b>1 237 562</b>	<b>623 851</b>	<b>613 711</b>
Urbane	Asnjëherë i/e martuar	186 012	83 130	102 882
	I/e martuar me kurorë	338 020	170 617	167 403
	I/e martuar pa kurorë	45 152	23 222	21 930
	Bashkëjetesë	4 298	2 183	2 115
	I/e ndarë, por ligjërisht I/e martuar	1 069	720	349
	I/e shkurorezuar	6 929	4 371	2 558
	I/e ve	40 194	32 999	7 195
	<b>Gjithsej</b>	<b>621 674</b>	<b>317 242</b>	<b>304 432</b>
Rurale	Asnjëherë i/e martuar	184 674	76 754	107 920
	I/e martuar me kurorë	341 926	173 344	168 582
	I/e martuar pa kurorë	44 379	23 027	21 352
	Bashkëjetesë	3 175	1 550	1 625
	I/e ndarë, por ligjërisht I/e martuar	491	260	231
	I/e shkurorezuar	2 999	1 405	1 594
	I/e ve	38 244	30 269	7 975
	<b>Gjithsej</b>	<b>615 888</b>	<b>306 609</b>	<b>309 279</b>

**Tab. 3.4 – Popullsia rezidente e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit martesor, gjinisë dhe grupmoshës**

GRUPMOSHA		STATUSI MARTESOR							
		Gjithsej	Asnjëherë i/e martuar	I/e martuar me kurorë	I/e martuar pa kurorë	Bashkëjetesë	I/e ndarë, por ligjërisht i/e martuar	I/e shkurorëzuar	I/e ve
Gjithsej	15-19	<b>122 613</b>	119 699	1 286	1 190	366	7	26	39
	20-24	<b>134 270</b>	113 494	13 411	6 163	821	67	246	68
	25-29	<b>113 474</b>	61 409	37 302	12 482	1 385	147	622	127
	30-34	<b>109 335</b>	29 981	60 825	15 790	1 198	197	1 094	250
	35-39	<b>103 883</b>	15 660	70 233	15 004	906	205	1 389	486
	40-44	<b>103 224</b>	9 625	77 015	13 091	733	202	1 509	1 049
	45-49	<b>105 345</b>	7 037	83 428	10 358	696	194	1 472	2 160
	50-54	<b>100 167</b>	5 120	82 374	6 806	453	161	1 233	4 020
	55-59	<b>91 084</b>	3 502	76 006	3 911	363	123	912	6 267
	60-64	<b>80 292</b>	2 315	65 689	2 304	213	112	661	8 998
	65-69	<b>66 300</b>	1 484	51 139	1 177	144	84	406	11 866
	70-74	<b>48 412</b>	753	32 906	649	106	29	236	13 733
	75-79	<b>31 383</b>	362	17 714	330	43	17	80	12 837
	80-84	<b>18 277</b>	170	7 964	188	28	9	34	9 884
	85+	<b>9 503</b>	75	2 654	88	18	6	8	6 654
	<b>Gjithsej</b>	<b>1 237 562</b>	<b>370 686</b>	<b>679 946</b>	<b>89 531</b>	<b>7 473</b>	<b>1 560</b>	<b>9 928</b>	<b>78 438</b>

Tab. 3. 4 – Popullsia rezidente e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit martesor, gjinisë dhe grupmoshës

(vazhdim)

GRUPMOSHA	STATUSI MARTESOR								
	Gjithsej	Asnjëherë i/e martuar	I/e martuar me kurorë	I/e martuar pa kurorë	Bashkëjetesë	I/e ndarë, por ligjërisht i/e martuar	I/e shkurorezuar	I/e ve	
Femra	15-19	59 251	57 292	863	838	215	3	21	19
	20-24	65 159	50 423	9 816	4 161	486	55	184	34
	25-29	54 693	22 389	23 480	7 505	731	105	402	81
	30-34	53 626	9 152	34 567	8 461	537	110	612	187
	35-39	51 260	4 970	37 215	7 364	443	120	780	368
	40-44	51 314	3 706	39 379	6 085	360	125	801	858
	45-49	54 877	3 727	42 894	5 003	354	117	897	1 885
	50-54	53 019	3 116	42 054	3 230	211	105	741	3 562
	55-59	47 742	2 060	37 689	1 722	164	78	542	5 487
	60-64	41 362	1 453	30 646	929	91	79	369	7 795
	65-69	33 855	860	22 302	439	53	51	224	9 926
	70-74	25 410	416	13 369	250	41	13	123	11 198
	75-79	16 773	189	6 404	129	22	11	55	9 963
	80-84	9 902	87	2 499	87	14	7	21	7 187
	85+	5 608	44	784	46	11	1	4	4 718
	<b>Gjithsej</b>	<b>623 851</b>	<b>159 884</b>	<b>343 961</b>	<b>46 249</b>	<b>3 733</b>	<b>980</b>	<b>5 776</b>	<b>63 268</b>
Meshkuj	15-19	63 362	62 407	423	352	151	4	5	20
	20-24	69 111	63 071	3 595	2 002	335	12	62	34
	25-29	58 781	39 020	13 822	4 977	654	42	220	46
	30-34	55 709	20 829	26 258	7 329	661	87	482	63
	35-39	52 623	10 690	33 018	7 640	463	85	609	118
	40-44	51 910	5 919	37 636	7 006	373	77	708	191
	45-49	50 468	3 310	40 534	5 355	342	77	575	275
	50-54	47 148	2 004	40 320	3 576	242	56	492	458
	55-59	43 342	1 442	38 317	2 189	199	45	370	780
	60-64	38 930	862	35 043	1 375	122	33	292	1 203
	65-69	32 445	624	28 837	738	91	33	182	1 940
	70-74	23 002	337	19 537	399	65	16	113	2 535
	75-79	14 610	173	11 310	201	21	6	25	2 874
	80-84	8 375	83	5 465	101	14	2	13	2 697
	85+	3 895	31	1 870	42	7	5	4	1 936
	<b>Gjithsej</b>	<b>613 711</b>	<b>210 802</b>	<b>335 985</b>	<b>43 282</b>	<b>3 740</b>	<b>580</b>	<b>4 152</b>	<b>15 170</b>

**Tab. 3.5 – Popullsia rezidente sipas përkatësisë etnike, gjinisë dhe grupmoshës**

GRUPMOSHA	PËRKATËSIA ETNIKE											
	Gjithsej	Shqiptar	Serb	Boshnjak	Turk	Rom	Ashkali	Egjiptian	Goran	Të tjerë	Preferojnë të mos përgjigjen	
Gjithsej	0-4	107 710	99 514	1 560	1 262	1 143	906	1 862	974	353	76	60
	5-9	117 272	108 356	1 782	1 443	1 343	906	1 861	1 014	399	115	53
	10-14	123 022	113 052	2 071	1 749	1 379	987	1 899	1 172	525	133	55
	15-19	122 613	112 716	2 213	1 874	1 284	944	1 703	1 126	548	119	86
	20-24	134 270	124 736	2 160	1 889	1 353	866	1 621	991	467	109	78
	25-29	113 474	105 137	2 116	1 750	1 425	629	1 116	660	447	119	75
	30-34	109 335	101 182	2 337	1 680	1 411	523	947	574	473	140	68
	35-39	103 883	95 386	2 510	1 728	1 466	504	880	609	586	148	66
	40-44	103 224	94 666	2 455	1 794	1 393	480	914	657	600	179	86
	45-49	105 345	96 915	2 417	1 816	1 377	428	856	648	650	165	73
	50-54	100 167	92 087	2 355	1 872	1 210	400	751	573	703	157	59
	55-59	91 084	83 243	2 422	2 012	1 066	379	586	479	705	128	64
	60-64	80 292	72 660	2 563	1 936	1 017	307	441	416	779	120	53
	65-69	66 300	59 193	2 704	1 580	985	215	348	308	798	125	44
	70-74	48 412	42 883	2 322	1 106	824	166	234	193	556	104	24
	75-79	31 383	28 234	1 374	671	445	56	119	120	286	54	24
	80-84	18 277	16 470	844	428	205	23	50	49	164	35	9
	85+	9 503	8 533	447	251	93	11	19	18	101	25	5
	<b>Gjithsej</b>	<b>1 585 566</b>	<b>1 454 963</b>	<b>36 652</b>	<b>26 841</b>	<b>19 419</b>	<b>8 730</b>	<b>16 207</b>	<b>10 581</b>	<b>9 140</b>	<b>2 051</b>	<b>982</b>
	<b>%</b>	<b>100</b>	<b>91.76</b>	<b>2.31</b>	<b>1.69</b>	<b>1.22</b>	<b>0.55</b>	<b>1.02</b>	<b>0.67</b>	<b>0.58</b>	<b>0.13</b>	<b>0.06</b>

Tab. 3.5 – Popullsia rezidente sipas përkatësisë etnike, gjinisë dhe grupmoshës

(vazhdim)

GRUPMOSHA	PËRKATËSIA ETNIKE											
	Gjithsej	Shqiptar	Serb	Boshnjak	Turk	Rom	Ashkali	Egjiptian	Goran	Të tjerë	Preferojnë të mos përgjigjen	
Femra	0-4	51 319	47 437	719	622	533	432	905	448	159	42	22
	5-9	55 891	51 583	841	672	621	456	940	494	200	59	25
	10-14	58 953	54 217	958	845	661	481	908	550	253	58	22
	15-19	59 251	54 487	1 051	906	619	473	836	522	261	54	42
	20-24	65 159	60 698	1 053	873	637	387	725	466	238	44	38
	25-29	54 693	50 693	1 027	799	727	307	511	312	220	60	37
	30-34	53 626	49 765	1 079	778	689	241	448	301	212	80	33
	35-39	51 260	47 071	1 202	862	715	253	458	294	276	91	38
	40-44	51 314	47 148	1 170	890	667	233	447	324	287	104	44
	45-49	54 877	50 694	1 120	917	692	223	427	328	328	103	45
	50-54	53 019	49 054	1 114	928	617	202	370	271	345	87	31
	55-59	47 742	43 783	1 173	1 033	549	193	286	244	376	68	37
	60-64	41 362	37 495	1 217	1 033	562	155	217	205	384	68	26
	65-69	33 855	30 192	1 331	843	517	116	178	168	410	76	24
	70-74	25 410	22 420	1 207	650	454	94	120	106	287	62	10
	75-79	16 773	15 005	752	409	251	32	58	63	144	40	19
	80-84	9 902	8 866	468	263	100	14	26	30	96	32	7
85+	5 608	5 037	244	161	58	7	4	11	65	20	1	
Gjithsej	790 014	725 645	17 726	13 484	9 669	4 299	7 864	5 137	4 541	1 148	501	
%	100	91.85	2.24	1.71	1.22	0.54	1.00	0.65	0.57	0.15	0.06	
Meshkuj	0-4	56 391	52 077	841	640	610	474	957	526	194	34	38
	5-9	61 381	56 773	941	771	722	450	921	520	199	56	28
	10-14	64 069	58 835	1 113	904	718	506	991	622	272	75	33
	15-19	63 362	58 229	1 162	968	665	471	867	604	287	65	44
	20-24	69 111	64 038	1 107	1 016	716	479	896	525	229	65	40
	25-29	58 781	54 444	1 089	951	698	322	605	348	227	59	38
	30-34	55 709	51 417	1 258	902	722	282	499	273	261	60	35
	35-39	52 623	48 315	1 308	866	751	251	422	315	310	57	28
	40-44	51 910	47 518	1 285	904	726	247	467	333	313	75	42
	45-49	50 468	46 221	1 297	899	685	205	429	320	322	62	28
	50-54	47 148	43 033	1 241	944	593	198	381	302	358	70	28
	55-59	43 342	39 460	1 249	979	517	186	300	235	329	60	27
	60-64	38 930	35 165	1 346	903	455	152	224	211	395	52	27
	65-69	32 445	29 001	1 373	737	468	99	170	140	388	49	20
	70-74	23 002	20 463	1 115	456	370	72	114	87	269	42	14
	75-79	14 610	13 229	622	262	194	24	61	57	142	14	5
	80-84	8 375	7 604	376	165	105	9	24	19	68	3	2
85+	3 895	3 496	203	90	35	4	15	7	36	5	4	
Gjithsej	795 552	729 318	18 926	13 357	9 750	4 431	8 343	5 444	4 599	903	481	
%	100	91.67	2.38	1.68	1.23	0.56	1.05	0.68	0.58	0.11	0.06	



Tab. 3.6 – Popullsia rezidente sipas religjionit, gjinisë dhe grupmoshës

GRUPMOSHA		RELIGJIONI						
		Gjithsej	Islam	Ortodoks	Katolik	Të tjerë	Asnjë besim fetar	Preferojnë të mos përgjigjen
Gjithsej	0-4	<b>107 710</b>	102 528	1 559	1 170	312	463	1 678
	5-9	<b>117 272</b>	111 543	1 789	1 444	346	442	1 708
	10-14	<b>123 022</b>	116 914	2 069	1 574	389	413	1 663
	15-19	<b>122 613</b>	116 052	2 220	1 909	425	404	1 603
	20-24	<b>134 270</b>	126 848	2 162	2 348	466	604	1 842
	25-29	<b>113 474</b>	106 342	2 119	1 941	587	763	1 722
	30-34	<b>109 335</b>	102 460	2 348	1 746	515	741	1 525
	35-39	<b>103 883</b>	97 433	2 533	1 433	486	560	1 438
	40-44	<b>103 224</b>	96 675	2 472	1 573	478	544	1 482
	45-49	<b>105 345</b>	98 363	2 439	1 945	464	504	1 630
	50-54	<b>100 167</b>	93 049	2 374	2 206	489	457	1 592
	55-59	<b>91 084</b>	83 928	2 429	2 133	534	507	1 553
	60-64	<b>80 292</b>	73 301	2 561	1 906	574	499	1 451
	65-69	<b>66 300</b>	59 901	2 690	1 592	487	451	1 179
	70-74	<b>48 412</b>	43 566	2 296	1 166	305	284	795
	75-79	<b>31 383</b>	28 408	1 350	805	193	159	468
	80-84	<b>18 277</b>	16 465	836	573	92	67	244
	85+	<b>9 503</b>	8 500	437	351	33	37	145
		<b>Gjithsej</b>	<b>1 585 566</b>	<b>1 482 276</b>	<b>36 683</b>	<b>27 815</b>	<b>7 175</b>	<b>7 899</b>
	<b>%</b>	<b>100</b>	<b>93.49</b>	<b>2.31</b>	<b>1.75</b>	<b>0.45</b>	<b>0.50</b>	<b>1.50</b>

Tab. 3.6 – Popullsia rezidente sipas religjionit, gjinisë dhe grupmoshës

(vazhdim)

GRUPMOSHA		RELIGJIONI						
		Gjithsej	Islam	Ortodoks	Katolik	Të tjerë	Asnjë besim fetar	Preferojnë të mos përgjigjen
Femra	0-4	51 319	48 885	721	538	151	210	814
	5-9	55 891	53 140	840	701	179	207	824
	10-14	58 953	56 058	961	739	189	219	787
	15-19	59 251	56 080	1 056	926	189	194	806
	20-24	65 159	61 627	1 057	1 136	221	283	835
	25-29	54 693	51 384	1 029	886	246	324	824
	30-34	53 626	50 431	1 088	860	238	295	714
	35-39	51 260	48 208	1 219	676	218	255	684
	40-44	51 314	48 159	1 189	787	226	223	730
	45-49	54 877	51 419	1 133	1 055	222	237	811
	50-54	53 019	49 499	1 129	1 148	266	186	791
	55-59	47 742	44 265	1 181	1 053	239	231	773
	60-64	41 362	38 022	1 216	1 007	246	205	666
	65-69	33 855	30 853	1 325	800	202	163	512
	70-74	25 410	23 043	1 187	638	121	97	324
	75-79	16 773	15 167	734	478	88	75	231
	80-84	9 902	8 902	462	342	44	24	128
	85+	5 608	5 040	239	215	18	20	76
		<b>Gjithsej</b>	<b>790 014</b>	<b>740 182</b>	<b>17 766</b>	<b>13 985</b>	<b>3 303</b>	<b>3 448</b>
	<b>%</b>	<b>100</b>	<b>93.69</b>	<b>2.25</b>	<b>1.77</b>	<b>0.42</b>	<b>0.44</b>	<b>1.43</b>
Meshkuj	0-4	56 391	53 643	838	632	161	253	864
	5-9	61 381	58 403	949	743	167	235	884
	10-14	64 069	60 856	1 108	835	200	194	876
	15-19	63 362	59 972	1 164	983	236	210	797
	20-24	69 111	65 221	1 105	1 212	245	321	1 007
	25-29	58 781	54 958	1 090	1 055	341	439	898
	30-34	55 709	52 029	1 260	886	277	446	811
	35-39	52 623	49 225	1 314	757	268	305	754
	40-44	51 910	48 516	1 283	786	252	321	752
	45-49	50 468	46 944	1 306	890	242	267	819
	50-54	47 148	43 550	1 245	1 058	223	271	801
	55-59	43 342	39 663	1 248	1 080	295	276	780
	60-64	38 930	35 279	1 345	899	328	294	785
	65-69	32 445	29 048	1 365	792	285	288	667
	70-74	23 002	20 523	1 109	528	184	187	471
	75-79	14 610	13 241	616	327	105	84	237
	80-84	8 375	7 563	374	231	48	43	116
	85+	3 895	3 460	198	136	15	17	69
		<b>Gjithsej</b>	<b>795 552</b>	<b>742 094</b>	<b>18 917</b>	<b>13 830</b>	<b>3 872</b>	<b>4 451</b>
	<b>%</b>	<b>100</b>	<b>93.28</b>	<b>2.38</b>	<b>1.74</b>	<b>0.49</b>	<b>0.56</b>	<b>1.56</b>

Tab. 3.7 – Popullsia rezidente sipas gjuhës amtare, gjinisë dhe moshës

GRUPMOSHA	GJUHA AMTARE							
	Gjithsej	Shqipe	Serbe	Boshnjake	Turke	Rom	Tjetër, specifiko	
Gjithsej	0-4	107 710	102 586	1 608	1 340	1 089	615	472
	5-9	117 272	111 616	1 830	1 531	1 269	592	434
	10-14	123 022	116 542	2 156	1 874	1 287	650	513
